



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Auditim financiar

Tiranë, shkurt 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1-4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	4-6
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-6
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	4-6
II.	HYRJA	6-7
1.	Objektivat dhe qëllimi	7-7
2.	Identifikimi i çështjes.....	7-7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7-8
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	8-8
5.	Kriteret e vlerësimit.....	8-8
5.	Standardet e auditimit.....	8-9
7.	Metodat e auditimit.....	9-9
8.	Dokumentimi i auditimit.....	9-9
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	10-105
	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	10-11
1.1	Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	11-18
2.1	Auditimi mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	18-25
2.6	Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave	25-34
3	Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike	35-49
4	Auditimi mbi Organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet, Kullotat) të transferuara me VKM.	49-54
5	Zbatimi i rekomandimeve	54-82
IV	REKOMANDIME	82-97

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a) Përshkrim i shkurtër i institucionit Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar në Bashkinë Pogradec, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 12.06.2024 deri në datën 19.07.2024 u krye auditimi, i cili kishte objekt: “Auditimi Financiar të Bashkisë Pogradec” dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 6 akt-konstatime. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i çdo vit i kësaj njësie të qeverisjes së përgjithshme është detyrim në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2, në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu, ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Pogradec, si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Vetëqeverisja vendore duhet të sigurojë qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është që të japë garanci dhe të rrisë nivelin e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet dhënies së opinionit me siguri

të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar, si dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Pogradec. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM –së.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas

ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme: verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 21 gjetje dhe ka dhënë 21 rekomandime, nga ku masa organizative me 17 gjetje dhe 17 rekomandime si dhe 4 gjetje-rekomandime në vlerën **255,682 mijë lekë** në fushën e të ardhurave.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave

- Të ardhura të munguara në vlerën **143,834 mijë lekë** nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga abonentët familiar.

- Të ardhura të munguara në vlerën **70,107 mijë lekë** nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga bizneset.

- Të ardhura të munguara në vlerën **40,440 mijë lekë** nga mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 1,913 persona debitorë.

- Të ardhura të munguara në vlerën **1,300 mijë lekë** nga subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre.

-Nga auditimi u konstatua se gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 168,828,141 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 148,802,909 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 20,025,232 lekë e cila vjenë si rezultat i rritjes së debitorëve të qirave etj. Nga analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në vlerën 143,834,560 lekë si dhe debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 40,440,441 lekë.

▪ Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve

Nga auditimi rezultoi se Pogradec ka në total 3,775 pasuri sipas VKM-ve përkatëse, nga ku rezulton se nuk është bërë pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet, nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Pogradec, nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Pogradec si dhe nuk ka krijuar komisionit e përbashkët në zbatim të VKM së nr.28 datë, 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve – ASHK ku kërkohet një person nga ASHK-ja në krijimin e komisionit me qëllim inventarizimin dhe regjistrimin dhe përditësimin e inventarve.

Nga analiza e llogarive të Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, rezulton se bashkia ka kryer procesin e inventarizimit të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 3,874,074 lekë, llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 698,494,722 lekë, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 115,508,891 lekë, llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,077,389,480 lekë, llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 11,985,774 leke dhe llogarisë 215 “Mjete transporti” në vlerën 9,276,022 lekë. Rezulton se vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozionit financiar 2023, është marrë bruto nga pasqyrat financiare. Nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Sektori i Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore.

Titullari i Bashkisë Pogradec të gjitha masat e menjëhershme duke i kërkuar ASHK-së Korçë caktimin e një personi ekspert të fushës, që merret me Menaxhimin e Aseteve, me qëllim ngritjen e grupit të përbashkët për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka Bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre me VKM.

Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave në Bashkinë Pogradec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2023 në vlerën **255,682 mijë** lekë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi Pasqyrat Financiare të aparatit të Bashkisë për vitin 2023:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pogradec për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Pogradec janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**", e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinionin e modifikuar, me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë e lidhura me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit, nga ku rezultuan anomalitë e mëposhtme:

- Bashkia Pogradec për vitin 2023 nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë, për ti dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare për tre njësitë e vartëse.

1. Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekracionit.

2. Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës Punëve Publike.

3. Qendra Arsimore.

- Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" janë përfshirë 41 projekte për të cilat drejtoria e financës nuk ka bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së

projektit.

- Rezulton se bashkia ka kryer procesin e inventarizimit të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 3,874,074 lekë, llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 698,494,722 lekë, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 115,508,891 lekë, llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,077,389,480 lekë, llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 11,985,774 leke dhe llogarisë 215 “Mjete transporti” në vlerën 9,276,022 lekë, pasi nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikisht këto zëra, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 300,000 lekë dhe më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 300,000 lekë. Kjo vlerë është e mbartur ndër vite e pa analizuar dhe ndikon në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të aktiveve afatgjata financiare. Referuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, Bashkia Pogradec është aksionare me 36.10% tek Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA, kapital në vlerë monetare prej 36,100 mijë lekë, e cila nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2023.

- Në llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në vlerën 143,834,560 lekë, si dhe debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 40,440,441 lekë.

- Bashkia Pogradec në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 347,178,628 mijë lekë e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2023 nuk ka planifikuar një grafik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura por është likuiduar vlera prej 146,099,377 lekë

I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1081/1 prot., datë 11.09.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 11.09.2024 deri në datën 18.10.2024, në subjektin Bashkia Pogradec u krye “Auditimi Financiar” për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. H. I. – Përgjegjës Grupi
2. M. N. – Anëtar
3. E. S. – Anëtar

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij.

- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹.

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700.
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Qëllimi i një auditimi financiar është të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të synuar në pasqyrat financiare të audituara. KLSH nëpërmjet auditimit financiar përcakton nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar. Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Pogradec është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Pogradec dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
2. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.
3. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Pogradec, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Strukturat drejtuese të njësive publike, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Strukturat drejtuese të njësive publike kanë përgjegjësi për vënien në dispozicion të audituesve të KLSH-së të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Përgjegjësia e audituesit për të hartuar dhe kryer procedurat e auditimit në përgjigje të risqeve të identifikuar të gabimeve materiale dhe vlerësimit gjatë planifikimit strategjik dhe planifikimit të detajuar. Audituesit kanë përgjegjësinë për të komunikuar çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e

arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Pogradec është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Pogradec. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së, nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim.
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”.
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Pogradec grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë .

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”.
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar".
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodat e auditimit

Në varësi të specifikave të subjektit të drejtimeve të programit të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme.

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Pogradec me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit kanë identifikuar dhe vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit, (b) implementimit, dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-J^a aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë

² ISSAI 1315

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar, *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike, *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur, dhe së fundi *kërkimi/shqyrtimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Në trajtim të këtij drejtimi të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj Bashkia e Pogradec: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullorja për sinjalizimin, planet mujore dhe vjetore të punës etj.
2. Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore,
3. Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, si dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
4. Shkresat për krijimin e grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).
5. Trajnimet e stafit, si dhe planifikimet për trajnime të tyre në një vit.
6. Regjistrin e riskut.
7. Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe Deklarata e cilësisë dhe Pyetëtori i vetëvlerësimit.
8. Plotësimi i pyetësorëve të KLSH-së për Bashkinë e Pogradec, dërguar me E-mail @bashkiaPogradec.gov.al.

Nga auditimi i dokumentacionit të vene në dispozicion nga Bashkia e Pogradec, në përgjigje të kërkesave të përshkruara më lart lidhur me MFK-në, grupi i auditimit rezulton me këto konstatime:

2.1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK -në. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmërisë të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen.

Bazuar në kapitullin III, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 titullari i institucionit është përgjegjës të zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërldhur me njëri-tjetrin:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në zbatim të kërkesave të nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar rezultoi se:

Për vitin 2023 Bashkia Pogradec ka funksionuar bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, të miratuar me Vendimin nr.21 me nr.530 prot., datë 29.01.2021, “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Pogradec” dhe Kodi i etikës i miratuar me Vendimin nr.113, datë 08.05.2020 “Kodin e Etikës dhe sjelljes së mirë për bashkinë Pogradec dhe njësitë vartëse”. Referuar kërkesave të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përsa i përket pjesës për Rregulloren e Brendshme të Njësisë Publike, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetet në legjislacionin përkatës, duke përmbajtur disa nga elementët thelbësore, që çdo rregullore duhet të ketë.

Rregullorja e Brendshme, ka përfshirë parimet kryesore për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.

Në rregulloren e brëndshme janë përcaktuar pengesat ligjore për punonjësit e bashkisë, parimi i ligjshmërisë, i ndalimit të konfliktit të interesave, mbrojtjes së interesit publik, transparencës, i ndershmërisë dhe parimi i bashkëpunimit.

Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimev Njerëzore.

Kodi i Etikës

-Në kodin e etikës trajtohet:

Neni 5 etika dhe sjellja etike.

Neni 9 mos abuzimi me pushtetin.

Neni 10 paanshmëria, ndershmëria dhe pavarësia.

Neni 27 konflikti i interesave.

Neni 30 profesionalizmi dhe shmangia e veprimeve që çenojnë figurën e punonjësit.

Neni 34 dhe paraqitja dhe veshja e përshtatëshme e punonjësve.

Nuk ka programe të trajnimit për implementimin e parimeve të mësipërme.

Bashkia nuk kryen trajnime të dedikuara për integritetin dhe sjelljen etike.

Politikat Menaxheriale.

Me urdhërin nr.730, datë 30.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për vitin 2023 i përbërë nga 5 anëtarë dhe 10 Ekiye për Menaxhimin e Programeve (EMP).

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion ky grup (GMS) nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma “b”, neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhërin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

- Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

Mbi strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit:

Për vitin 2023, numri i punonjësve në Bashkinë Pogradec, referuar Vendimit Nr. 15, datë 20.01.2023., “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, njësisive administrative dhe insitucioneve në varësi për vitin 2023”, i ndryshuar me vendimin nr.188, datë 11.09.2023 ka qenë si vijon, numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në aparatit e Bashkisë Pogradec, të agjencive dhe institucioneve në vartësi të Bashkisë 760 punonjës.

Komponenti “Menaxhimi i Riskut”:

Në zbatim të kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar rezultoi se:

Kryetari i Bashkisë me urdhërin nr. 731, datë 30.12.2022 ka ngritur grupin për menaxhimin dhe koordinimin e riskut në bashkinë Pogradec. Koordinatori Kryesor i Riskut është caktuar zv kryetari i Bashkisë Pogradec z. P. Z. dhe anëtarë çdo përfaqësues i strukturave funksionale në Bashki.

Për menaxhimin e riskut Bashkia Pogradec ka hartuar Regjistri përmbledhës i riskut për vitin 2023. Ky regjistër është hartuar sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, referuar shkresës nr.1757/11 prot., datë 29.09.2023. Në përgjithësi, është i plotësuar për të gjitha kategoritë që përmban një regjistër risku. Në këtë regjistër janë përshkruar disa nga risqet kryesore për vitin 2023, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej tyre.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut për vitin 2023.

Bashkia Pogradec nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, si urdhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016.

- Nuk janë përgatitur planet e vperimit për minimizimin e risqeve me nivel të lartë.
- Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit. Për sa më sipër këto janë në kundërshtim me urdhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- Gjithashtu në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK-së në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Komponenti: “Veprimtaritë e Kontrollit”:

Në zbatim të kërkesave të nenit 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar“rezultoi se:

Titullari i bashkisë nuk ka miratuar veprimtaritë e kontrollit, që përfshin procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Në rregulloren e brendëshme janë përcaktuar rregullat e përgjithsme për delegimin e detyrave. Gjithashtu për cdo pozicion pune janë vendosur dhe përgjegjësitë duke ndarë detyrat dhe mos

lejuar që i njëjti punonjës të jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin apo kontrollin.

Mungojnë kontrollet pas faktit për të parë situatën e riskut që është konstatuar nga drejtuesit e njësive publike.

Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në zbatim të kërkesave të nenit 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar rezultoi se:

Bashkia Pogradec për komponentin informim dhe komunikim i ka përcaktuar mënyrën e informimit dhe komunikimit në Rregulloren e brendshme dhe Kodin e Etikës. Shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike.

Në Rregulloren e brendshme në nenin 37 është përcaktuar komunikimi elektronik. Ky nen udhëzon punonjësit e Bashkisë për përdorimin e postës elektronike të bashkisë për komunikim dhe shkëmbim elektronik të dokumentave zyrtare, brënda dhe jashtë institucionit. Bashkia trajton dhe vlerëson të gjithë informacionin elektronik si çështje të brendshme duke ndjekur të gjitha praktikatat dhe procedurat përkatëse për sigurimin, ruajtjen, si dhe shkatërrimin e tij, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” Kreu V.

Gjithashtu në Kodin e etikës në nenin 32 trajtohet komunikimi i brendshëm dhe elektronik.

Komponenti: “Monitorimi”

Në zbatim të kërkesave të nenit 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar rezultoi se:

Me shkresën nr. 826/1 prot., datë 14.02.2024, nga Bashkia Pogradec është hartuar dhe dërguar në MFE Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

Me shkresë nr.826 prot., datë 14.02.2024, Bashkia Pogradec ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësoin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK-së, në përputhje me Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli V, Shtojca 2 “Pyetësoi i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Bashkia Pogradec nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

-Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.

Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit nga audititi i brendshëm bëhet nëpërmjet auditimeve që NJAB kryen dhe pasqyrohet në raportet e auditimit.

2.1.2 Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Spektori i Auditit të Brendshëm për subjektin Bashkia Pogradec është në varësi të Kryetarit të Bashkisë dhe është i përbërë nga: Përgjegjësi i Spektorit të Auditit të Brendshëm dhe në varësinë e

tij 2 specialistë. Organizimi i sektorit të auditit të brendshëm është përcaktuar në organigramën dhe në Rregulloren e brendëshme të institucionit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) për periudhën e auditimit 01.01.2023-31.12.2023 ka qënë e përbërë nga këta punonjës:

Znj. K. V. Përgjegjës,

Znj. E. P. Specialiste,

Znj. P. A. Specialiste., të cilët janë të pajisur me certifikatën “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

Përgjegjësi i sektorit znj. K.V. është e pajisur me certifikatën e “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” dy specialistet znj. P. A. dhe znj. E. P. në datën 15.09.2023 janë pajisur me certifikatën “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

NJAB ka hartuar Programin strategjik për periudhën 2023-2025, i cili është miratuar nga Kryetari i bashkisë.

Gjithashtu, është hartuar Karta e Auditimit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr.979 prot., datë 24.02.2020.

Bashkia Pogradec, titullari i saj nuk ka ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm kjo në kundërshtim ligjin Nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”. Nga dokumentacionet e vendosura në dispozicion përgjegjësi i sektorit me shkresë Nr.32/58 prot., datë 22.05.2024 i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë Pogradec për raportimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në vitin 2023. Në këtë shkresë përgjegjësi i sektorit kërkon mbështetje nga Kryetari i Bashkisë për ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm për zbatimin e rekomandimit të lënë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën 2023-2025 ka planifikuar auditime si më poshtë:

Për vitin 2023.

- 1.Drejtorinë ekonomike dhe menaxhimi financiar.
- 2.Drejtorinë juridike dhe prokurimeve publike.
- 3.Sektorin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi
- 4.Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore.
- 5.Njësia administrative Proptisht.
- 6.Njësia administrative Velcan.
- 7.Njësia për Koordinimin e Integritimit European dhe Ndihmës së Huaj.

Për vitin 2024.

1. Drejtorinë ekonomike dhe menaxhimi financiar.
2. Drejtorinë juridike dhe prokurimeve publike.
- 3.Drejtoria e planifikimit urban dhe zhvillimit të territorit.
- 4.Drejtoria e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit (IMT).
- 5.Njësia administrative Udënisht.
6. Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore.
- 7.Njësia administrative Dardhas.

Për vitin 2025.

1. Drejtorinë ekonomike dhe menaxhimi financiar.
2. Drejtorinë juridike dhe prokurimeve publike.
- 3.Njësia administrative Trebinjë.
- 4.Qendra arsimore.
- 5.Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore.
- 6.Ndërmarrja e parqeve dhe rekreacionit.
- 7.Njësia administrative Bucimas.

Njësia e Auditimit në Bashkinë Pogradec gjatë vitit 2023 ka realizuar 7 auditime sipas planit të miratuar. Nga auditimet e realizuar për vitin 2023 NJAB ka lënë rekomandime për subjektet e audituara si mëposhtë:

- Drejtoria ekonomike dhe menaxhimi financiar janë lënë 12 rekomandime prej të cilave 2 janë zbatuar, 10 janë në proces zbatimi.
- Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike janë lënë 10 rekomandime prej të cilave 2 janë zbatuar dhe 8 janë në proces zbatimi.
- Njësia Administrative Proptisht janë lënë 4 rekomandime prej të cilave 2 janë zbatuar dhe 2 janë në proces zbatimi.
- Njësia Administrative Velcan janë lënë 4 rekomandime prej të cilave 1 është zbatuar dhe 3 janë në proces zbatimi.
- Njësia për Koordinimin e Integritit European dhe Ndihmës së Huaj janë lënë 6 rekomandime prej të cilave 5 janë zbatuar dhe 1 është në proces zbatimi.
- Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore, janë lënë 7 rekomandime prej të cilave 4 janë zbatuar dhe 3 janë në proces zbatimi.
- Sektori i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, janë lënë 5 rekomandime prej të cilave 3 janë zbatuar dhe 2 janë në proces zbatimi.

Duhet të vijohet me një analizë të rekomandimeve të dhëna dhe sipas statusit tyre.

Në total NJAB ka lënë 48 rekomandime të ndara si mëposhtë:

- 29 rekomandime të përmirësimit të sistemeve përkatësisht në Dr.Ekonomike dhe menaxhimin financiar, Dr.juridike/prokurimeve, Dr. taksave dhe tarifave vendore, Njësia për Koordinimin e Integritit European dhe Ndihmës së Huaj, Njësia Adm. Velcan, Njësia Adm. Proptisht.
- 5 rekomandime të karakterit organizativ përkatësisht në Dr. Ekonomike dhe menaxhimin financiar, Dr.juridike/prokurimeve, Dr. taksave dhe tarifave vendore, Sektori i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.
- 13 rekomandime të tjera përkatësisht në Dr. Ekonomike dhe menaxhimin financiar, Dr.juridike/prokurimeve, në Dr. taksave dhe tarifave vendore, Sektori i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, Njësia për Koordinimin e Integritit European dhe Ndihmës së Huaj.

Për sa mësipër grupi i auditimi kostatoi se:

Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm nga titullari i institucionit, në kundërshtim me nenin 12, germa “b” e ligjit Nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin Publik*” i ndryshuar, dhe ka sjellë për pasojë mungesën e monitorimit e këshillëdhënies për titullarin e njësise publike, si dhe mungesën mbështetjes për njësinë e auditimit të brendshëm.

Rëndësia e Komitetit dhe detyrat që ai ka shërbejnë për një aktivitet sa më eficient, të pavarur dhe ndihmues për titullarin e institucionit dhe NJAB.

2. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, janë ngritur grupet e punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallëra e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj., gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Me Urdhrin nr. 953 dt 31.12.2021, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2023- 2025 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 128 datë 22.11.2022, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Pogradec: me shkresën nr. 1071/1prot., datë 07.12.2022

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

a-PBA 2023-2025 miratuar respektivisht me VKB-në nr.57, datë 22.06.2022 me VKB-në nr.128 , datë 22.11.2022.

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2023-2025 janë përcaktuar “Përshkrimi i çdo programi”, “Politikat e programit”, “Qëllimi Politikës së programit”, “Objektivat e politikës së programit”.

Tabela nr.1, Urdherat dhe vendimet per PBA 2023-2025

PBA	Urdhëratë GMS		Urdhëratë EMP		VKB			Nr.	
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Objekti	Nr.	Datë	Programe	shënime
2023-2025	953	31.12.2021	953	31.12.2021	miratim kalendari	6	20.01.2022		
					miratim tavanëve të shpenzimeve	31	23.03.2022	12	në afat
					miratimi i tabelave të PBA	57	22.06.2022	12	në afat

Burimi: Drejtoria e Financës

Miratimi i tavanëve të buxhetit afatmesëm 2023-2025 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 31, datë 23.03.2022, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Bashkia Pogradec nuk ka paraqitur në Këshillin Bashkiak raportin “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitet 2022-2024”, e cila paraqitet jo më vonë se 31 Janar, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB-në nr. 144, datë 28.12.2022 konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut me shkresën nr 5/1 prot datë 11.01.2023. Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën 1,292,137,080 lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 432,109,000 lekë, transferta specifike ka vlerën 234,293,000 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 1,292,137,080 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 1,292,137,080 lekë.

Gjatë vitit 2023, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetorë 2023). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB-në nr.18, datë 17/02/2023 është marrë vendim për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2023, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 133,627,636 lekë.

- VKB-ja nr. 48 datë 23.05.2023”Dërgohet rritja e pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale”Këshilli i Bashkisë vendosi të miratojë shtesë 7,771,718 lekë.

- VKB-ja nr. 71 datë 26.07.2023”Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të vendimit nr. 328 dt 31.05.2023”Këshilli i Bashkisë vendosi të miratojë shtesën 21,846,240 lekë.

- VKB-ja nr. 78 datë 26.07.2023 "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2023" Aktmarreveshje ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe UNDP, Këshilli i Bashkisë vendosi të miratojë shtesat 3,515,099 lekë.
- VKB-ja nr. 119 datë 27.10.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 84/2022" Për buxhetin e vitit 2023" Këshilli i Bashkisë vendosi të miratojë shtesën prej 15,000,000 lekë.
- VKB-ja nr. 137 datë 21.12.2023 "Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 84/2022" Për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar Këshilli i Bashkisë vendosi të miratojë shtesën 52,375,000 lekë.

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

a-PBA 2023-2025 miratuar respektivisht me VKB-ja nr.57, datë 22.06.2022. Faza I me VKB-ja nr. 91, datë 19.08.2022 "Miratimin e programit të rishikuar buxhetor afatmesëm 2023-2025" dhe Faza përfundimtare VKB-ja nr 128 dt 22.11.2022

Në formë tabele paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2023 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Faza I PBA 2023	Faza II PBA 2023	Projekt Buxhet 2023
600	Paga	427,813	463,420	449,820	511,150
601	Sigurime Shoqërore	70,196	85,700	74,249	85,495
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	364,608	488,761	509,495	575,760
604	Transferta të Brendshme	62,747	70,496	70,496	95,720
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,064,866			609
I	Shpenzime Korrente	1,990,230	1,108,377	1,104,060	1,268,734
230	Kapitale të Patrupëzuara	23,655	14,904	14,904	
231	Kapitale të Trupëzuara	185,635	298,939	306,205	241,803
	Shp. Kapitale me financim të brendshëm		313,843		
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim të huaj				
II	Shpenzime Kapitale	209,290	313,843	321,109	241,803
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
I+II +III Totali I Shpenzimeve		2,199,520	1,422,220	1,425,169	1,510,537

Gjatë vitit 2023 është bërë Analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujore, Raportet e monitorimit janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve ligjore.

Konkretisht është hartuar raporti i monitorimit dhe i performances për vitin 2023 dhe është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.826/5 prot., datë 28.02.2023.

Me vendimin e këshillit bashkiak (VKB-në) nr. 144 datë 28.12.2022, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë 760 punonjes , institucioneve në varësi, njërive administrative ,numri i punonjësve me kontratë të përkohshme dhe funksionet e deleguara për vitin 2023. Me vendimin nr. 74 datë 26.07.2023 është miratuar niveli i pagave të Bashkisë Pogradec.

Të dhëna në formë tabele për planifikimin e buxhetit bazë dhe ndryshimet jepen në tabelën në vijim:

Njesia Bashkia Pogradec+ Ndërmarrjet e vartësisë Viti 2023								
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti vitit paraardhës Viti 2022	PBA Plan Viti 2023	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti i 12-mujori	Diferenca	% e realizimit
				Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023			
600	Paga	420,194	421,370	456,001	459,001	511,150	476,093	93%
601	Sigurime Shoqërore	68,923	73,700	82,639	83,639	85,495	80,531	94%

600+60	Paga +Sigurime	489,117	495,070	538,640	542,640	596,645	556,624	93%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	364,569	497,429	503,074	507,920	575,760	395,027	69%
603	Subvencione							
604	Transferta Korente të Brendshm	62,747	70,496	81,200	81,200	95,720	81,386	85%
605	Transferta Korente të Huaja							
606	Transf. per Buxh. Fam. & Indiv	16,186	50	171	171	609	598	98%
602-606	Shpenzime operative	443,502	567,975	584,445	589,291	589,291	477,011	81%
	Shpenzime Korrente	932,619	1,063,045	1,123,085	1,131,931	1,268,734	1,033,635	81%
230	Kapitale të Patrupëzuara	23,655	14,904	0	0	0	0	0%
231	Kapitale të Trupëzuara	185,635	390,271	280,915	280,915	241,803	144,483	60%
Totali	Shpenzime Kapitalë	209,290	405,175	280,915	280,915	241,803	144,483	60%
Totali	(korrente + kapitale)	1,141,909	1,468,220	1,404,000	1,412,846	1,510,537	1,178,118	78%

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e më poshtme:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	596,645	524,069	72,576
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	589,291	579,991	9,300
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	241,803	321,109	-79,306
4	Investime nga FZHS			
	Total i planit fillestar	1,510,537	1,425,169	85,368
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar			
6	Shpenzime për pagat (600+601)			
7	Shpenzime (602.604.609)			
	<i>Grant i kushtëzuar (230-231)</i>			
	Gjithsej	1,510,537	1,425,169	85,368

Burimi: Drejtoria e financës

Nga auditimi konstatohet se nga krahasimi i planit përfundimtar të vitit 2023 me atë të PBA-së 2023-2025, ka një rritje të planit përfundimtar në vlerën **85,368** mijë lekë.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet kur kanë ndodhur brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB-së.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Tabela e ndryshimeve në buxhet paraqitet në vijim:

në mijë lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjatë vitit		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull			
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
Viti 2023	Nr.144, dt.28/12/2022	1,292,137,080	Nr.18, dt 17.02.2023	133,628	600+601,Paga dhe sigurime.	6,949		6,949
					602- 609ShP. te tjera	77,126		77,126
					230+231 (Investime)	49,553		49,553
			Nr.48, dt. 23.05.2023	7,772	600+601,Paga dhe sigurime.	7,772	604	7,772
			Nr.71, dt. 26.07.2023	21,846	600+601,Paga dhe sigurime.	21,846	604	21,846
			Nr.78, dt. 26.07.2023	3,515	600+601,Paga dhe sigurime.	516		516
					230+231 (Investime)	2,999		2,999
			Nr.119, dt. 27.10.2023	15,000	602, ShP. operative	7,500		7,500
					230+231, investime	7,500		7,500
			Nr.137, dt. 21.12.2023	52,375	602, ShP. operative	41,584	604	41,584
					230+231, investime	10,791		10,791
					602, ShP. operative			
					230+231, investime			
					230+231, investime			
					602, ShP. operative			
					230+231, investime			
					602, ShP. operative			

Burimi: Bashkia Pogradec

Shenim: Ndryshimet e tjera ne buxhetin e Bashkisë Pogradec për vitin 2023 jane kryer brenda programeve buxhetore ,midis artikujeve , dhe nuk ka qene nevoja për vendim këshilli Bashkiak kjo në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018” Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore. Shtesat dhe paksimet janë bërë me urdhër të nenpunesit Autorizues dhe janë miratuar në Degën e Thesarit Pogradec.

Për zbatimin e buxhetetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera, ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2023, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në mijë lekë

Nr.	Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Pogradec, për vitin 2023. Në lekë			
	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %
	Paga 600	511,150	476,093	93%
	Sigurime shoqërore 601	85,495	80,531	94%
	ShP. Operat602+ F. Rezervë	575,760	395,027	69%
	Subvencion Ujësjiellësi, etj. 603			
	K. Q Emergj Civile 604	95,720	81,386	85%
	Nd/Ekonom invalid 606	609	598	98%
	Mjete ne ruajtje 466			
	Investime 230-231	241,803	144,483	60%
	Totali	1,510,537	1,178,118	78%

Burimi: Bashkia Pogradec

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën 1,510,537 mijë lekë i barabartë me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën 1,510,537 mijë lekë.

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën 1,510,537 mijë lekë, ndërsa realizimi 1,178,118 mijë lekë, ose në masën 78%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 511,150 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 476,093 mijë lekë, ose në masën 93%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 94%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 575,760 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 395,027 mijë lekë, ose në masën 69%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 241,803 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 144,483 mijë lekë, ose në masën 60 %.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Pogradec ka diferenca me vlerën e planifikuar.

Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 1,510,537 mijë lekë, ndërsa realizimi 1,178,118 mijë lekë, ose në masën 78%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara , i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 241,803 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 144,483 mijë lekë, ose në masën 60%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Pogradec në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me germën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me

përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Pogradec, z. I. X. si dhe znj. I. K., me detyrë Drejtoreshë e Financës.

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2023 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2023. Veprimet e mësipërme janë në perputhje me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Fondet e shpenzuara për përballimin e situatave të pa parashikuara.

Në VKB-në nr. 144, datë 28.12.2022 është miratuar për vitin 2023 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total lekë, si vijon:

- fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 1,000,000 lekë,
- fondi i emergjencës civile në vlerën 18,500,000 lekë.

Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të parashikojnë nga burimet e veta të financimit për emergjencat civile, jo më pak se 1.7% të totalit të buxhetit. Pjesa tjetër e financimit për mbrojtjen civile do të mbulohet në formën e transfertës së kushtëzuar nga buxheti qendror në vitin buxhetor 2023”.

Në detyrim sa më sipër nga Bashkia Pogradec në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar fondi i emergjencës civile në vlerën 18,500,000 lekë, në masën 1.7% të buxhetit.

Me shkresën nr.1650 prot., datë 24.03.2020, të Ministrit të Mbrojtjes me lëndë “Kërkesë për marrjen e masave urgjente për përdorimin e fondeve për mbrojtjen civile” (tepër urgjente), drejtuar të gjitha bashkive të vendit, thuhet “Në mbështetje të nenin 65 të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ...bashkitë për zvogëlimin e rriskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, mbështeten në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Në këtë shkresë është kërkuar që bashkitë të raportojnë për vlerën e fondeve që kanë në dispozicion për mbrojtjen civile dhe sa për qind të buxhetit përbëjnë.

Vlera e planifikuar dhe realizuar e fondit reserve dhe fondit të emergjences paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Burimi i financimit	Vlera e planifikuar	Vlera e shpenzuar	Vlera e pa shpenzuar
1	Transfertë e pakushtëzuar	12,765,258	10,232,629	2,532,629
2	Transfertë specifike (e kushtëzuar)	46,911,885	46,149,992	761,893
3	Të ardhurat e veta	18,500,000		

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve, (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.).

Detyrimet e prapambetura viti 2023

në lekë

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv	Vlera e paguar gjatë vitit 2023 për detyrimin e prapambetur(vlera	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara	Detyrim iprapambetur i krijuar vetëm gjatë	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2023
------------------------------	---------------------------------	--------------------------------	---	---	--	---

		më 31.12.2022	e paguar për kolonën 3)	më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2023)	vitit 2023 (situata më 31.12.2023)	
1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
4864100	Dety. për vendime gjyqesore	56,874,096	16,605,464			40,268,632
4864200	Dety. për shërbime	86,311,399	16,406,720			69,904,679
4864300	Dety. për mirëmbajtje	601,529	388,800			212,729
4864400	Dety. për investime	65,169,028	11,477,332			53,691,696
4864600	Dety. për mallra	10,124,639	1,590,675		3850	8,537,814
4864601	Dety. për sig shoq	18,448,308				18,448,308
4864602	Dety. për sig shend	2,559,255				2,559,255
4864603	Dety. për tat mbi të ardh pers	625,898				625,898
4864903	Dety. për tatime të tjera	719,190				719,190
4864903	Transferte tek individet	6,114,900				6,114,900
4864400	Tet për investime (06)	99,630,386	99,630,386			0
	Totali	347,178,628	146,099,377		3,850	201,083,101
Detyrime të prapambetura nga FZHR (Ministritë e linjës)						
	Detyrime ne total					201,083,101

Burimi: Bashkia Pogradec

Vlera e raportuar nga Bashkia Pogradec në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 është **201,083,101 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 826/5 prot., datë 28.02.2024 drguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore.

Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpe nzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	201,083,101		17.07%
Llogaria ekonomike	Emërtimi			

4864100	Vendime Gjyqesore	40,268,632		
4864200	Det.Prap. Sherbime	69,904,679		
4864201	D.P.EneriElektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	212,729		
4864400	Det.Prap. Investime	53,691,696		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	8,537,814		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	18,448,308		
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	2,559,255		
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	625,898		
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	719,190		
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv	6,114,900		
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	201,083,101	1,178,118,095	17.07%

Burimi: Bashkia Pogradec

Bashkia Pogradec në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 347,178,628 mijë lekë e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2023 nuk ka planifikuar një grafik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura por është likuiduar vlera prej 146,099,377 lekë.

Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2023), është ulur **(347,178,628-201,083,101)**, me 146,095,527 lekë, ose në masën prej 42%. Gjithashtu rezulton se bashkia ka planifikuar investime pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2023.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

➤ **Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:**

Struktura organizative për vitin 2023 është miratuar me Vendimin nr. 15, datë 20.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë Pogradec ku pjesë e saj përfshihet edhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (në vijim DTTV). Kjo drejtori sipas strukturës së miratuar ka në përbërje të saj 17 punonjës konkretisht: 1 drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, 1 përgjegjës i

Sektori, 1 jurist, 3 specialist për llogaritjen dhe rakordimin të taksave dhe tarifave vendore për biznesin, 1 punonjës administrative, 1 shef i Njesisë, 6 punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe 3 punonjës për mbledhjen e tarifës së parkimit të automjeteve.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Me VKB-në nr. 132, datë 22.11.2022, është miratuar paketa dhe niveli i taksave dhe tarifave vendore të cilat do të aplikohen në territorin e Bashkisë Pogradec për vitin 2023. Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Pogradec parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Pogradec për vitin 2023 paraqitet në mënyrë analitike sipas aneksit nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Për vitin **2023** planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **616,306 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **391,334 mijë lekë** ose në masën **63%** me një diferencë mosrealizimi në vlerën **199,873 mijë lekë**.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

a. “Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura” është planifikuar në vlerën 20,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 18,047 mijë lekë ose realizuar në masën 90%.

b. “Taksa e rentës minerare 5%” është planifikuar në vlerën 200 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 326 mijë lekë ose realizuar në masën 163%.

c. “Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 10,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 26,611 mijë lekë ose realizuar në masën 266%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

a. “Taksa vendore mbi biznesin e vogël” është planifikuar në vlerën 4,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 450 mijë lekë ose realizuar në masën 11%.

b. “Taksa mbi pasurinë e paluajtshme” është planifikuar në vlerën 82,062 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 62,903 mijë lekë ose realizuar në masën 77%.

c. “Taksa mbi ndërtesën” është planifikuar në vlerën 71,629 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 56,496 mijë lekë ose realizuar në masën 79%.

d. “Taksa mbi ndërtesën familje” është planifikuar në vlerën 42,559 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 31,000 mijë lekë ose realizuar në masën 73%.

e. “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” është planifikuar në vlerën 100,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 11,909 mijë lekë ose realizuar në masën 12%.

f. “Tarifa me menaxhimin të mbetjeve” është planifikuar në vlerën 125,978 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 97,363 mijë lekë ose realizuar në masën 77%.

g. “Tarifa e pastrimit për familjet” është planifikuar në vlerën 78,320 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 51,066 mijë lekë ose realizuar në masën 65%.

h. “Tarifa e pastrimit për biznesin” është planifikuar në vlerën 47,058 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 45,697 mijë lekë ose realizuar në masën 97%.

i. “Tarifa për ndriçimin publik” është planifikuar në vlerën 48,059 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 33,797 mijë lekë ose realizuar në masën 70%.

j. “Tarifa për ndriçimin publik nga familjet” është planifikuar në vlerën 48,059 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 33,797 mijë lekë ose realizuar në masën 70%.

k. “Tarifa për gjelbërimin” është planifikuar në vlerën 74,916 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 53,992 mijë lekë ose realizuar në masën 72%.

l. “Tarifa për gjelbërimin nga familjet” është planifikuar në vlerën 37,625 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 22,299 mijë lekë ose realizuar në masën 59%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për 13 zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për 2 zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është

real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve. Sipas vlerësimit të audituesve kjo kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.

Nga DTTV nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme. Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifatat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave. Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Pogradec që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:**

Në rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me Vendimin nr. 4, datë 12.01.2022, nuk është përfshirë personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve me agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me ta. Vetëm për ndjekjen e arkëtimeve dhe rakordimeve me Agjentin Tatimor, Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Pogradec është parashikuar si detyrë konkretisht në nenin 69 “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore” të rregullores së brendshme. Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Pogradec në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në ifrastrukturë dhe DRSHTRR Pogradec në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Pogradec dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Pogradec.

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Pogradec, konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj dhe vjetorë, por që janë të paplota. Nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, konkretisht:

- Për ASHK (nga shitja e pasurisë),
- Për Drejtoria e Transportit (për mjetet qarkullues),
- Për Drejtoria Rajonale Tatimore Pogradec (tatim fitim thjeshtuar):
- Për Ujësjiellës Kanalizime SHA Pogradec (abonentët familjarë),
- Për Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave (renta minerare).

Bashkia Pogradec nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agentët tatimorë, Bashkia Pogradec, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117, ku përcaktohet që “Dënimet për agentët e mbajtjes së tatimit në burim, agentët e taksave dhe agentët e tarifave”. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agentët tatimorë është Ujësjiellës Kanalizime Sh.a Pogradec. Është e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me agentin tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

Konstatohet se sipas DTTV Bashkia Pogradec mos arkëtimet nga ana e Drejtorisë Rajonale Vendore (ASHK Pogradec) janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës për të cilat nga Bashkia Pogradec është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektësh, pa paraqitur dokumentacionin mbi kryerjen e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër Bashkia Pogradec duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme. Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

Të ardhurat e vjela nga agentët tatimorë për vitin 2023 paraqiten si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 2023	Realizimi 2023	%
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit(Agjenti DRT Pogradec)	4,000,000	449,662	11
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (Agjenti DRT Pogradec)	10,000,000	26,610,911	266
3	Taksa e regjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR)	20,000,000	18,047,351	90
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK)	6,200,000	4,117,613	66
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana....)	200,000	326,558	163
Totali		40,400,000	49,552,095	123

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec.

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Pogradec kryhet në programin Excel. Drejtoria nuk kryen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullohet nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Pogradec i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë kompjuterik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV për të cilat mund të

ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Situata e lëvizjes së subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Pogradec bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
subjektet	1	Xhiro 0-3	2022	1407	112	70	1449
subjektet	2	Xhiro 3-5	2022	113	31	35	109
subjektet	3	Xhiro 5-8	2022	70	15	33	52
subjektet	4	Xhiro 8-14	2022	97	29	34	92
subjektet	5	Xhiro mbi 14	2022	206	34	15	225
Total 1+5				1893	201	167	1927
subjektet	6	Xhiro 0-3	2023	1449	45	32	1462
subjektet	7	Xhiro 3-5	2023	109	9	4	114
subjektet	8	Xhiro 5-8	2023	52	31	12	71
subjektet	9	Xhiro 8-14	2023	92	13	3	102
subjektet	10	Xhiro mbi 14	2023	225	5	31	199
Total 6+10				1927	165	142	1952

Ndryshimet mujore sipas QKB-së

periudha	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	ntor	dhjetor	totali
të reja	22	16	14	10	15	13	10	10	14	15	19	7	165
ndryshime	50	37	55	37	60	49	54	36	43	41	60	34	556
çregjistrime	6	3	8	4	7	6	8	5	7	4	3	7	68
totali	78	56	77	51	82	68	72	51	64	60	82	48	789

Nga Bashkia Pogradec nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi) dhe për të gjithë subjektet.

Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për abonentët familjarë dhe subjektet si biznesi i vogël dhe i madh paraqiten si më poshtë:

➤ Detyrimet e familjarëve:

Ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Pogradec është lidhur aktmarrëveshja me shkresën nr. 18 prot., datë 31.01.2012. Kontratat dypalëshe shërbejnë për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimin dhe regjistrimin e abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, nga DTTV janë mbajtur aktrakordimet mujore në lidhje me situatën debitorë si dhe numrin apo lidhjen e kontratave të reja me UKP Sh. A.

➤ **Njoftimet e bëra për familjarët, masat e marra dhe masat shtrënguese**

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj...

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten të dhënat detyrimet e abonentëve familjarë për taksat dhe tarifatat vendore, si më poshtë:

Lekë					
Nr.	Emërtimi	Deri më datën 31.12.2022	Viti 2023	Totali progresiv	Numri i familjeve debitoare
1	Taksa e tokës bujqësore	2,218,367	594,029	2,812,396	7,669
2	Taksa e ndërtesës	21,674,281	5,301,041	26,975,322	6,782
3	Taksa e truallit	5,733,265	687,951	6,421,216	6,782
3	Tarifa e pastrimit	47,560,277	10,742,181	58,302,458	6,782
4	Tarifa e gjelbërimit	16,228,345	3,686,807	19,915,152	6,782
5	Tarifa e ndriçimit	16,467,216	5,302,618	21,769,834	6,782
6	Tarifa e mirëmbajtje varreze	5,636,095	2,011,087	7,647,182	6,782
Totali		115,508,846	28,325,714	143,834,560	7,669

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec.

Nga auditimi konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë në vlerën **115,508,846 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë krijuar debitorë në vlerën **28,325,714 lekë**. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, për abonentët familjarë janë në vlerën **143,834,560 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec** si më poshtë:

1. Vlera **2,812,396 lekë** për **7,669 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore.
2. Vlera **26,975,322lekë** për **6,782 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës.
3. Vlera **6,421,216 lekë** për **6,782 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i taksës së truallit.
4. Vlera **58,302,458 lekë** për **6,782 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit.
5. Vlera **21,769,834 lekë** për **6,782 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i tarifës së gjelbërimit.
6. Vlera **7,647,182 lekë** për **6,782 familje** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i tarifës së mirëmbajtjes së varrezave.

➤ **Menaxhimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore:**

Nga auditimi i kaluar është konstatuar se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjekte si biznes i vogël në vlerën 14,285,720 lekë dhe biznes i madh në vlerën 42,854,000 lekë ku totali shkon në vlerën **57,139,720 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë mbledhur në total 14,309,074 lekë duke ngelur debitor në vlerën **42,830,646 lekë që i përket periudhës 2011-2022. Përgjatë vitit 2023** janë krijuar debitorë të rinj në total në vlerën **27,277,277 lekë të ndarë** subjekte si biznes i vogël në vlerën

7,677,327 lekë dhe biznes i madh në vlerën 19,599,950 lekë ku në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, për subjektet biznes i vogël dhe i madh është në vlerën **70,107,923 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec**. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nr.	Njësia Administrative	Deri në datë 31.12.2022	2023	Totali progresiv
1	Subjektet fizike biznesi i vogël Pogradec	7,616,382	3,213,951	10,830,333
	Subjektet juridike biznesi i madh Pogradec	7,636,390	4,656,749	12,293,139
2	Subjektet fizike biznesi i vogël Njësia Administrative Buçimas	4,129,326	1,593,271	5,722,597
	Subjektet juridike biznesi i madh Njësia Administrative Buçimas	7,125,041	5,824,401	12,949,442
3	Subjektet fizike biznesi i vogël Njësia Administrative Udënisht	2,084,315	2,024,929	4,109,244
	Subjektet juridike biznesi i madh Njësia Administrative Udënisht	4,451,050	989,664	5,440,714
4	Subjektet fizike biznesi i vogël Njësia Administrative Çëravë	1,566,303	376,006	1,942,309
	Subjektet juridike biznesi i madh Njësia Administrative Çëravë	277,120	1,293,983	1,571,103
5	Subjektet fizike biznesi i vogël Njësia Administrative Proptisht	277,398	250,597	527,995
	Subjektet juridike biznesi i madh Njësia Administrative Proptisht	4,874,930	3,408,509	8,283,439
6	Subjektet fizike biznesi i vogël Njësia Administrative Velçan	228,682	122,190	350,872
	Subjektet juridike biznesi i madh Njësia Administrative Velçan	2,521,715	3,426,644	5,948,359
7	Subjektet fizike biznesi i vogël Njësia Administrative Trebinjë	41,994	26,447	68,441
	Subjektet juridike biznesi i madh Njësia Administrative Trebinjë	-	-	-
8	Subjektet fizike biznesi i vogël Njësia Administrative Dardhas	-	69,936	69,936
	Subjektet juridike biznesi i madh Njësia Administrative Dardhas	-	-	-
	Totali	42,830,646	27,277,277	70,107,923

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec.

Nga auditimi rezultoi se Bashkisë Pogradec ka njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive me shkresën nr. 2345 prot, datë 07.06.2023, bashkëlidhur lista e subjekteve debitore për vitin 2022 dhe shkresën nr. 2345/1 prot., datë 07.06.2023, me lëndë “Kërkesë për bllokimin e llogarive bankare” drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë në Shqipëri. Si rrjedhojë e bllokimit të llogarive vlera e arkëtuar është **1,351,600 lekë**.

Me shkresën nr.2696/3, datë 10.07.2023, me lëndë “Kërkesë të dhënash” i është kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Transporteve Korçë. Në vijim të kërkesës nr.6495/1 prot,19.07.2023 Drejtoria Rajonale e Transporteve Korçë ka vendosur barren në Regjistrin të Barrëve Siguruese (R.B.S).

Regjistri i Barrëve Siguruese ka dërguar me shkresën përcjellëse” nr.4550/1 prot, datë 05.12.2023 Regjistri i Barrëve, si dhe ka bashkangjitur kopjet fizike të Regjistrimit dhe Rezultatet e Kërkimit të Regjistrimit të Pretendimeve Shtetërore- Njoftimet C.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore i ka kërkuar vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore Qendrës Kombëtare të Biznesit, për subjektet debitorë me shkresat më poshtë:

"Kërkesë për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore",nr.5089 prot.,datë15.12.2023.

"Kërkesë për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore",nr.5089 prot.,datë 15.12.2023.

"Kërkesë për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore",nr.5089/1 prot.,datë 15.12.2023.

"Kërkesë për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore",nr.5089/2 prot.,datë 15.12.2023.

"Kërkesë për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore" nr.5089/3 prot.,datë 15.12.2023,

"Kërkesë për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore" nr.5089/4 prot. datë 15.12.2023.

"Kërkesë për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore" nr.5089/5 prot., datë 15.12.2023.

"Kërkesë për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore",nr.5089/6 prot., datë 15.12.2023.

"Kërkesë për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtat pasurore",nr.5089/7 prot.,datë 15.12.2023.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore komunikon elektronikisht çdo ditë me Qendrën Kombëtare të Biznesit, duke e vënë në dijeni nese subjektet e kërkuara kanë detyrime pranë Bashkisë Pogradec, për të mos lejuar kalimin e debitorëve me status pasiv ose mbyllje.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore ka kallëzuar për procedim penal pranë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, subjektin "L.", me Nipt: L.....P, me administrator z.O. D., për mospagim taksash dhe tarifash vendore, me shkresën nr.2296 prot,datë 05.06.2023, në zbatim të Ligjit nr.7895,datë 27.01.1995,"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve".

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë ezaurur masat për arkëtimin e detyrimeve, vlera debitoare ka ardhur duke u rritur. Konkretisht për vitin 2023 janë regjistruar debitor të në vlerën 27,277,277 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që: "Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi, c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre, ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit", Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.

➤ Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Pogradec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave emërore për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e Aluizinit Pogradec janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe të destinuara për regjistrim në ZVRPP (sot ASHK Pogradec).

Nga auditimi konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë detyrimi për këtë taksë është në vlerën **22,207,998 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, vlera e detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 18,232,443 lekë. Në total detyrimi për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë më datë 31.12.2023, është në vlerën **40,440,441 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec**. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Lekë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë				
Viti	Persona	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë	Vlera e arkëtuar	Vlera e detyrimit
Deri më datë 31.12.2022	1470	59,310,593	37,102,595	22,207,998
2023	443	28,248,710	10,016,267	18,232,443
Totali/Progresim	1913	87,559,303	47,118,862	40,440,441

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec.

Nga auditim rezultoi se Bashkia Pogradec, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **40,440,441 lekë**. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se në territorin e Bashkisë së Pogradecit dhe në Njësitë Administrative Buçimas dhe Çerravë figurojnë 14 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre. Nga 14 subjekte janë pajisur me autorizim 14 subjekte, nga të cilët 11 subjekte kanë paguar vlerën e plotë të licencës dhe për këto subjekte është lëshuar licencë më afat 5- vjeçar në vlerën 11,000,000 lekë ndërsa 1 subjekte është pajisur me autorizim 1 vjeçar nga bashkia Pogradec. Deri me datë 18.10.2024 ka mbetur pa u likuiduar vlera prej 1,300,000 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e bashkisë Pogradec. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë								
Nr.	Subjekti	Nipti	Fillimi	Përfundimi	Detyrime për tu paguar	Detyrimi i paguar	Diferenca	Kryerja e pageses
1	" H. " SH.P.K.	J.....H	31.10.2022	25.06.2024	300,000		300,000	
2	" A. " SH.P.K.	L.....E	26.11.2022	26.11.2027	1,000,000	1,000,000		Credins Bank 27.06.2023
3	" S. " SH.P.K.	K.....V	26.11.2023	26.11.2024	200,000	200,000	0	Raifaiszen Bank 27.07.2023
4	" E. " SH.P.K.	K.....O	19.11.2023	19.11.2028	1,000,000		1,000,000	
5	" A. " SH.P.K.	K.....G	21.09.2020	21.09.2025	1,000,000	1,000,000	0	Raifaiszen Bank 03.08.2021
6	" B. " SH.P.K.	J.....Ë	15.12.2022	15.12.2027	1,000,000	1,000,000	0	BKT Bank 22.12.2022
7	" B. " SH.P.K.	J.....Ë	04.08.2020	04.08.2025	1,000,000	1,000,000	0	Raifaiszen Bank 13.12.2021
8	" B. " SH.P.K.	J.....Ë	15.12.2022	15.12.2027	1,000,000	1,000,000	0	BKT Bank 03.08.2021
9	" G. " SH.P.K.	K.....B	05.06.2020	24.06.2025	1,000,000	1,000,000	0	BKT Bank 24.06.2020
10	" G. " SH.P.K.	K.....B	05.10.2022	05.10.2027	1,000,000	1,000,000	0	BKT Bank 20.04.2023
11	" O. " SH.P.K.	J.....I	19.11.2021	19.11.2022	1,000,000	1,000,000	0	ALPHA BANK 28.12.2022
12	" G. " SH.P.K.	K.....T	19.11.2022	19.11.2027	1,000,000	1,000,000	0	ALPHA BANK 14.11.2022
13	" G. " SH.P.K.	K.....T	19.11.2021	19.11.2026	1,000,000	1,000,000	0	ALPHA BANK 10.11.2022
14	" G. " SH.P.K.	K.....T	19.11.2021	19.11.2026	1,000,000	1,000,000	0	ALPHA BANK 17.11.2022
Totali					12,500,000	11,200,000	1,300,000	

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec.

➤ **Kontratat për dhënie me qira të ndërtesave:**

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Pogradec nuk ka lidhur asnjë kontratë për dhënie me qira të ndërtesave, por është aktive 1 kontratë enfiteozë e lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe subjektit përfitues z. V. Z. më datë 23.04.2004, për marrjen me qira të një sipërfaqe 55 m² për përdorim ambient “Bar lokal” për administratën e bashkisë me vlerë qiraje prej 135,000 lekë në vit . Për këtë kontratë deri më datën 31.12.2023, nuk rezulton të ketë detyrime.

➤ **Kontratat për dhënie me qira të sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike:**

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Pogradec nuk ka lidhur asnjë kontratë për dhënie me qira të sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike, por janë aktive 11 kontrata të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi me sipërfaqe totale 3,315 m² dhe vlerë kontrate 2,882,280 lekë. Për këto kontrata deri më datën 31.12.2023, nuk rezulton të ketë detyrime.

➤ **Kontratat për dhënie me qira të sipërfaqeve për ushtrimin aktivitet të koncesionarëve për HEC-et:**

Për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, Bashkia Pogradec nuk ka lidhur asnjë kontratë koncensiononi për HEC, por janë aktive 8 kontrata të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi me sipërfaqe totale 30.298 ha dhe vlerë kontrate 5,440,607 lekë. Për këto kontrata deri më datën 31.12.2023, nuk rezulton të ketë detyrime. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Nr.	Subjektet	Nipti	Administrator	Sipërfaqja	Afati i kontratës	Vlera e kontratës	Detyrimi 01.01.2023-31.12.2023	Detyrim i mbetur më 31.12.2023
1	Hec L.	L.....H	H. G.	5.141 ha	08.11.2017-29.10.2027	2,136,876	2,136,876	0
2	H. E.	K.....K	H. G.	11.126 ha	28.05.2019-28.05.2029	248,650	248,650	0
3	H. E.	K.....K	E. K.	1.554 ha	08.11.2022-08.11.2022	713,335	713,335	0
4	Hec B.	K.....S	R. M.	1.6935 ha	29.04.2015-28.04.2050	496,800	496,800	0
5	P.-E.-S.	K.....S	N. K.	6.833 ha	22.05.2019-22.05.2029	1,157,415	1,157,415	0
6	H. I.	K.....I	B. H.	0.909 ha	07.08.2018-06.08.2028	134,851	134,851	0
7	L. E.	L.....N	N. X.	1.366 ha	11.07.2018-10.07.2028	302,090	302,090	0
8	M. Hec	K.....D	A. X.	1.676 ha	16.11.2017-15.11.2027	250,590	250,590	0
Totali				30.298 ha		5,440,607	5,440,6070	

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec.

➤ **Të ardhurat nga asetet e fondit pyjor kullor:**

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore, kullorore dhe improduktive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Pogradec për të cilat nuk janë lidhur kontrata qiraje referuar dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Takave dhe Tarifave Vendore.

Në territorin e Bashkisë Pogradec ushtrojnë aktivitet 32 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës (22 subjekte të cilat ushtrojnë aktivitet në zonat e mbrojtura dhe 8 subjekte që ushtrojnë aktivitet në zonat jo të mbrojtura), nga të cilat 30 prej tyre nuk kanë lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullorore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private.

-Për vitin 2023 janë aktive 2 kontrata konkretisht:

a. Më datë 08.10.2013, ndërmjet Komunës Udenisht përfaqësuar nga z. D. T. Kryetar i Komunës dhe Subjektit “P.” SH.P.K. përfaqësuar nga Administratori z. R. B. është lidhur kontrata e qirasë me afat 10 vjeçar me sipërfaqe 4,995 m² me vlerë kontrate 219,780 lekë në vit e cila është pjesë e fondit pyjor kullosor, ngastra nr. 95,96/4 për ushtrimin e veprimtarisë vendosjen dhe magazinimin e materialeve të ndërtimit, si dhe ushtrimin e veprimtarive të tjera në funksion të aktivitetit të shoqërisë. Për këtë kontratë deri më datën 31.12.2023, nuk rezulton të ketë detyrime.

b. Më datë 14.12.2018, ndërmjet Bashkisë Pogradec përfaqësuar nga z. E. K. Kryetar i Bashkisë dhe Subjektit “J.” SH.P.K. përfaqësuar nga Administratori z. A. G. është lidhur kontrata e qirasë me afat 5 vjeçar me sipërfaqe prej 0.55 ha për vendosjen e objekteve ndihmëse dhe sipërfaqen prej 0.95 km rrugë në shfrytëzim të minierës me vlerë kontrate 644,800 lekë në vit e cila është pjesë e fondit pyjor kullosor për shfrytëzim minerali hekur-nikel në karrierë.

Në vijim paraqiten subjektet e pajisur me leje minerare nga MIE dhe statusi i tyre për vitin 2023 që nuk janë lidhur kontrata qiraje. Për këtë kontratë deri më datën 31.12.2023, nuk rezulton të ketë detyrime.

c. Për 24 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës të cilat ushtrojnë aktivitet në fushën e shfrytëzimit të burimeve minerare të klasifikuara në zonat e mbrojtura, Bashkia Pogradec nuk ka lidhur kontrata qiraje, por theksojmë që këto subjekte janë në juridiksionin e Agjencisë së Kombëtare së Zonave të Mbrojtura dhe të ardhurat nga qiratë grumbullohen nga kjo agjenci.

Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Nr. lejes Minerare	Data e dhënies së lejes	Emërtimi	Adresa Vendodhja	Lloji i mineralit	Administrator	Nipt	Sip Km ²	Sip ha
1	609	16.03.2001	B. SH.P.K.	Hija e zezë	Krom	B. I.	J.....H	0.001	0.1
2	655	09.04.2002	K. SH.P.K.	Miniera e Kromit Pojskë	Krom	A J.	K.....A	0.0674	6.74
3	721/1	05.09.2013	Sh. SH.P.K.	Saselishtë	Gur Gëlqeror	Sh. K.	K.....C	0.048	4.8
4	768/1	17.06.2015	N. SH.P.K.	Çerravë	Gur Gëlqeror	U. L.	K.....E	0.022	2.2
5	831	18.02.2004	B. SH.P.K	“Mademi” Peshkëpi	Kuarc	B. I.	J.....H	0.01	1
6	910	01.09.2005	F. SH.P.K. dhe A. SH.P.K.	Damba e Shlleraeve	Hekur Nikel	E.B.	K.....V	0.023	2.3
7	939/1	18.04.2006	B. SH.P.K.	Përroi i Gllavës, Çerravë	Gur Gëlqeror	B. I.	J.....H	0.005	0.5
8	980	04.12.2006	J.SH.P.K.	Debrovë	Hekur Nikel	A. G.	K.....O	0.53	53
9	981	12.12.2006	D. SH.P.K.	Damba Hudënishtë, Pogradec	Hekur Nikel	G. A.	K.....V	0.099	9.9
10	1022	12.06.2007	R. SH.P.K.	Çervenakë Fe-Ni-Si	Hekur Nikel Ni-Si	B. B.	L.....B	0.079	7.9
11	1114	12.12.2007	J. SH.P.K.	Çervenaka Juglindore	Hekur Nikel	A. G.	K.....O	0.65	65
12	1242	24.09.2008	R. - SH.P.K.	Çervenaka Juglindore	Hekur Nikel	L. K.	J.....Q	0.55	55
13	1357	04.06.2009	J. SH.P.K.	Çervenaka Lindore	Hekur Nikel	I. V.	K.....N	0.0175	1.75
14	1830	24.12.2010	O. SH.P.K.	Guri i Kuq Perëndimi i Liqenit	Hekur Nikel	I. P.	K.....P	8.934	893.4
15	1615	07.03.2013	M. SH.P.K.	B. i tollovicës Pogradec	Krom	L. E.	L.....R	0.596	59.6
16	1665	04.09.2013	D. SH.P.K.	Mëmlisht	Krom	G. B.	L.....U	0.16	16
17	1729	08.10.2014	Ch. SH.P.K.	Rodokal	Krom	A. L.	L.....C	0.93	93
18	1781	12.11.2015	B. SH.P.K.	Leshnicë	Rërë Kuarc		J.....H	0.088	8.8
19	1830	25.01.2017	E. SH.P.K.	Gropa e Palit	Krom		L.....H	0.495	49.5
20	1838	24.07.2017	A. SH.P.K.	Trebinjë	Gur Gëlqeror		L.....A	0.066	6.6

21	1854	16.02.2018	B. SH.P.K.	Bllacë, Çërravë	Rërë Kuarc		J.....H	0.022	2.2
22	1882	18.12.2019	C. SH.P.K.	Proptisht	Hekur Nikel	S. M.	L.....A	0.48	48
23	1892	01.07.2020	A. SH.P.K.	Miniera e qymyrit Alarup, Çërravë	Qymyr Guri		L.....P	0.29	29
24	1724/1	25.11.2019	M. SH.P.K.	Katjel, Rodokali Verior dhe Jugor	Hekur Nikel		L.....F	0.162	16.2

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec.

d. Në territorin e Bashkisë Pogradec ushtrojnë aktivitet privat 8 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, subjekte të cilat nuk kanë lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullosore, por shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private.

Referuar VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar me VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe prodhim i lëndës drusore dhe jodrusore pyjore”, pika 2, lidhja nr. 2, pika nr. 6/1, pika nr. 9/5 dhe nr. 9/6, në përcaktohet që: “Pika 2. Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifatat dyscheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij”.

Lidhja nr. 2, “Tarifat dyscheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive”.

Pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materiale shpirtërore, direkt nga sipërfaqja (karrierë)

Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës **lekë/ha/vit**

1 vit 2-5 vjet 6-10 vjet

1 Inproduktive 540 000 / 495 000 / **440 000**

6 Improduktive -1-5 vjet 7,800 lekë dhe 6-10 vjet 62,000 lekë.

Detyrimi total për 8 subjekte për të cilat nuk është lidhur kontratë për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor kullosor për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023 është në vlerën **18,172,200 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec.**

Në menyre të detajuar paraqiten si vijon:

Nr.	Nr. lejes Minerare	Data e dhënies së lejes	Emërtimi	Adresa Vendodhja	Lloji i mineralit	Administrator	Nipt	Sip Km ²	Sip ha	Lekë	
										Vlera për vitin 2023	Detyrimi për vitin 2023
1	980	04.12.2006	J. SH.P.K.	Debrovë	Hekur Nikel	A. G.	K.....O	0.53	53	62,000	3,286,000
2	1022	12.06.2007	R. SH.P.K.	Çervenakë Fe-Ni-Si	Hekur Nikel Ni-Si	B. B.	L.....B	0.079	7.9	62,000	489,800
3	1615	07.03.2013	M. SH.P.K.	B. i tollovcës Pogradec	Krom	L. E.	L.....R	0.596	59.6	62,000	3,695,200
4	1729	08.10.2014	C. SH.P.K.	Rodokal	Krom	A. L.	L.....C	0.93	93	62,000	5,766,000
5	1781	12.11.2015	B. SH.P.K.	Leshnicë	Rërë Kuarc		J.....H	0.088	8.8	62,000	545,600

6	1838	24.07.2017	A.SH.P.K.	Trebinjë	Gur Gëlqeror		L.....A	0.066	6.6	62,000	409,200
7	1882	18.12.2019	C. SH.P.K.	Proptisht	Hekur Nikel	S. M.	L.....A	0.48	48	62,000	2,976,000
				Katjel, Rodokali Verior dhe Jugor	Hekur Nikel					62,000	
8	1724/1	25.11.2019	M.SH.P.K.				L.....F	0.162	16.2		1,004,400
Totali									293.1		18,172,200

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec.

Konkluzioni mbi situatën e borxhit tatimor dhe kontratave për dhënien me qira të aseteve

Nga auditimi konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore dhe ato të kontratave janë debitorë abonentët familjar, biznes i madh dhe i vogël etj., në vlerën **180,547,490 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë krijuar debitorë në vlerën **75,135,434 lekë**. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, janë në vlerën **255,682,924 lekë e cila përbën të ardhura të munguar për buxhetin e Bashkisë Pogradec** si më poshtë:

				Lekë
Lloji i taksës dhe tarifës	Deri më 31.12.2022	01.01.2023- 31.12.2023	Progresive	
Detyrimet nga abonentët familjarë	115,508,846	28,325,714	143,834,560	
Biznesi i madh dhe biznesi i vogël	42,830,646	27,277,277	70,107,923	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	22,207,998	18,232,443	40,440,441	
Subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre		1,300,000	1,300,000	
Totali	186,415,519	75,835,434	255,682,924	

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. I. X. Kryetar i Bashkisë Pogradec, znj. A. P. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, z. K. B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit, znj. A. M. me detyrë Shef i Njesisë së Kontrollit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, z. E. B. me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Mirëmbajtjeve dhe Punëve Publike, z. A. B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve.

2.3.Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Pogradec” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Pogradec si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

***Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.**

Bashkia Pogradec për vitin 2023 nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë, për t'i dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare.

Në vartësi të Bashkisë Pogradec janë tre njësi vartëse e konkretisht:

- Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekracionit.
- Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike.
- Qendra Arsimore.

Pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën 2023, të Njësive ekonomike në vartësi të Bashkisë Pogradec, janë dorëzuar në degën e thesarit Pogradec, ndërsa në Drejtorinë Ekonomike, në Sektorin e Financës të Bashkisë Pogradec nuk janë dorëzuar.

Veprimi dhe mos veprimi janë në mosrespektim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, neni 9, pika 4, germa “d”, neni 12 pika 2. germa “b”

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, neni 9, pika 4, germa “d” dhe neni 12, pika 2, germa “b”.

Neni 9 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues pika 4. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:

germa (d) planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së njësisë publike.

Neni 12 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues pika 2. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së:

germa (b) raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave.

UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar kapitulli II, pikat 98, 99, 100, 101, germa “b”, pika 118.

Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika 98. Hartimi i informacionit kontabël të konsoliduar në njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të mbështetet në parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit dhe të përgatitjes e paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore individuale të njësive, për nivelet përkatëse të qeverisjes në të cilat bëhet konsolidimi i informacionit. Ky konsolidim është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të prodhohet një informacion i dobishëm, i kuptueshëm dhe i besueshëm, në shërbim të vendimmarrjeve të qeverisjes së përgjithshme, në nivele qendrore dhe lokale.

Pika 99. Pasqyrat financiare përmbledhëse të konsoliduara kanë si qëllim të përgjithshëm dhënien e informacionit të besueshëm tek organet përkatëse vendimmarrëse, nëpërmjet:

- Sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimit të tyre.
- Sigurimit të informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësive dhe realizimin e kërkesave mbi mjetet monetare.
- Sigurimit të informacionit që lidhet me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet
- Sigurimit të informacionit për vlerësimin e performancës së njësive raportuese.

Pika 100. Në nivelet përkatëse të përgatitjes, pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të japin një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për këto elemente:

- Aktivët, detyrimet, aktivët neto/fondet neto si dhe
- Të ardhurat, shpenzimet, fluksin e mjeteve monetare.

Pika 101. Në pasqyrat financiare përmbledhëse të konsoliduara duhet të grupohet informacioni (duke bërë eliminimet dhe duke mënjeluar dublimet) në nivelet e mëposhtme:

b) Për njësitë e organeve të vetëqeverisjes vendore:

- Në nivel organi të vetëqeverisjes vendore, me të gjitha njësitë e varësisë.

Pika 118. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit.

• **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare të aparatit të bashkisë janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Pogradec për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr. 1442 prot. datë 26.03.2024 konfirmuar nga Dega e Thesarit Pogradec. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Pogradec dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

• **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• **Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të aparatit të bashkisë, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Totali i Aktivit për vitin 2023 është në vlerën **4,088,017,305 lekë** dhe për vitin 2022 është **2,547,851,134 lekë**, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2023

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit, llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën **226,635,012 lekë**.

Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Pogradec kjo llogari është për vlerën **226,635,012 lekë**. Konstatohet se “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor e pasqyruar në formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte”. të paraqitur është e në shumën e “Mjeteve monetare dhe ekuivalente të tyre” në vlerën **226,635,012 lekë** e pasqyruar në formatin nr. 1. Nga analiza e llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” paraqitet në vlerën

226,635,012 lekë e cila nuk rakordon me llogarit kundërparti në pasiv të bilancit, respektivisht llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” paraqitem në vlerën 138,122,996 lekë dhe logaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” paraqitet në vlerën 127,590,645 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr. 8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQP” pika 46/a , 49, 50, i ndryshuar

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **50,368,936 lekë** dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **11,290,306 lekë**, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej **39,078,630 lekë** rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 40,394,162 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 1,726,973 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 38,667,189 lekë, e cila përfaqëson shtesat e gjendjes së mallrave në fund të vitit 2023 e analizuar

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 9,974,774 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 9,563,333 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 411,441 lekë, e cila përfaqëson shtesat e gjendjes së mallrave në fund të vitit 2023 e analizuar

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 205,038,479 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 182,440,549 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i mos kryerjes se pagesave ndaj kreditorëve të ndryshëm në lidhje me investimet dhe shërbimet e ndryshme.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 168,828,141 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 148,802,909 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 20,025,232 lekë e cila vejnë si rezultat i rritjes së debitorëve të qirave, etj. Nga analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në vlerën 143,834,560 lekë si dhe debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 40,440,441 lekë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Liçensave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2

-**Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** (debitorë) më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 36,210,338 lekë (Formati nr.1). Kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2023 të cilat trashëgohen në vitin 2024, e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financimi i pritshëm nga buxheti” e cila paraqitet në vlerën 36,210,338 lekë, por nuk rakordon me klasën katër në pasiv të bilancit respektivisht: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me

to” për vlerën 147,725,695 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 15,027,116 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 2,088,586 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 22,902,333 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 3,166,177 lekë dhe llogaria 467 “Kreditor të ndryshëm” në vlerën 46,383,532 lekë cka ka sjell një nënvlersim të llogareisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” në vlerë 201,083,101 lekë që i përket vlerës së detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE me shkresën nr. 826/5 prot., datë 28.02.2024 dhe regjistruar në llogarinë 12 “Rezultatet e mbartura” me vlerë 201,083,101 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë, ato i përkasin subjektit, janë të vlerësuara në mënyrë korrekte, janë regjistruar në mënyrë korrekte, është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme, informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore,
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**,
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta,
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm,
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivitet e blera janë kryer teste për 5 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë),
- Për Aktivitet e marra falas janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes,
- Aktivitet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për të siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar.
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.).
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivitet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime” dhe “gjendjen e llog “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”).

Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,938,419,614 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,570,242,533 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,938,419,614 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 36,506,228 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 55,235,141 lekë, ku diferenca në ulje prej 18,728,913 lekë i përket vlerës së amortizimit. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar në aneksin nr. 3 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në totalin e llog 202- *Studime dhe kërkime*”, nga 41 projekte për të cilat drejtoria e financës nuk ka bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimet e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”** (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: *“Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivit, si dhe vlerësimin e mëposhtëm:*

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicioni financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit.

- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM”

Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 16/b. d** të cilat përcaktojnë: “Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:

b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23) dhe

- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës “b” më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).

Mbi Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM në vlerën prej **1,938,419,614** lekë sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023 përbëhet nga:

- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 3,874,074 lekë.

- Llogaria 211 "Pyje, Plantacione" në vlerën 698,494,722 lekë.
- Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 115,508,891 lekë.
- Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujre" në vlerën 1,077,389,480 lekë.
- Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" në vlerën 11,985,774 leke.
- Llogaria 215 "Mjete transporti" në vlerën 9,276,022 lekë.
- Llogaria 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 7,944,819 lekë.
- Llogaria 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara" në vlerën 4,631,125 lekë.
- Llogaria 28 "Caktime të Aktiveve Afatgjata" në vlerën 4,631,125 lekë.

Në vitin paraardhës 2022, vlera totale neto e AAM-ve paraqitet në shumën 1,570,242,533 lekë.

Duke analizuar veprimet e shtesave të AAM-ve vlerësuar me koston historike, sipas të dhënave të siguruar nga zyra e financës paraqiten si në aneksin nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga analiza e Llogarive të Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale", rezulton se Bashkia ka kryer procesin e inventarizimit të llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" në vlerën 3,874,074 lekë, llogarisë 211 "Pyje, Plantacione" në vlerën 698,494,722 lekë, llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 115,508,891 lekë, llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujre" në vlerën 1,077,389,480 lekë, llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" në vlerën 11,985,774 leke dhe llogarisë 215 "Mjete transporti" në vlerën 9,276,022 lekë. Rezulton se vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozicionit financiar 2023, është marrë bruto nga pasqyrat financiare. Nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirembajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.

Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2023, Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar kapitulli II, pika 6, 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika 6. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues,

Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël). Nënpika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2, Paragrafi - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata jo materiale".

Pika 33. Llogaritë përkatëse në klasën 2 funksionojnë si më poshtë vijon:

a) Për shtesat nga rivlerësimi:

Do të debitohen llogarit e klasës 2 të aktiveve afatgjata dhe

Do të kreditohet llogaria 109 "Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve"

Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” (Aparati i Bashkisë) më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 4,631,125 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,631,125 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlerën 4,631,125 lekë është e mbartur nga vitet e mëparshme për të cilat kontabilizimi është kryer pa dokumentacion mbështetës si procesverbal mbi vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit apo vendimmarrje nga Këshilli Bashkiak për nxjerrje të aktiveve jashtë përdorimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimi e MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”.

3.Në rubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 300,000 lekë dhe më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 300,000 lekë. Kjo vlerë është e mbartur ndër vite e pa analizuar dhe ndikon në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të aktiveve afatgjata financiare.

Mbi kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitet 2023 rezultoi se: Bashkia Pogradec në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 36.10% tek Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A me NUIS M.....U, me vlerë nominale 100.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 36,100 mijë lekë e cila nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2023, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35 ku citohet “Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investitorit në përputhje me paragrafët 37-42 të SNK 27.

4.Në rubrika, investime.

Llogaria (230, 231) “Investime”, për (AAJM/AAM) sipas të dhënave të paraqitura në pasqyrën e pozicionit Financiar për periudhën raportuese ushtrimore 2023 paraqiten me vlerë 1,630,749,036 lekë, ku nga vlera prej 603,083,834 lekë gjendje më 31.12.2022. Shtesat për vitin 2023 janë në vlerën 1,256,936,583 lekë dhe paksimet në vlerën 229,271,380 lekë.

Për investimet e kryera gjatë vitit 2023 është debituar llogarinë (231) dhe kredituar llogaritë Klasa (4) Në fund të vitit me kapitalizmin e tyre është kredituar llogaria (231) dhe janë debituar llogaritë (20) dhe (21) “Aktive afatgjata”. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmblodhur është analizuar si vijon:

Llogaria	Emertimi	Gjendja 31.12.2022 (sipas printimit të bilancit elektronik)	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2023 (sipas bilancit të institucionit)
				Amortizimi Viti 2022	
2302100	Shpenz. Per rritjen e AQ-studime ose kerkime	6,415,109	3,720,000	9,720,000	415,109
230200	Studime e kerkime	10,724,520	0	10,724,520	0
2310500	Regjis Toke bujqesore	0	0		0
2311300	Shpenz. Per rritjen e AQT-plantacione	1,314,355	0		1,314,355
2312101	Hidrolzolim tarace	2,108,508	0		2,108,508
2312103	Shpenzime per rritjen e AQT-ndertesa shkollore	45,345,182	90,862,718		136,207,900
2312104	Shpenzime per rritjen e AQT-ndert.sociale	0	2,372,073	2,372,073	0
2312115	Pritat e Lumenjve	(0)	0		0
2312116	Shpenzime per rritjen e AQT-ndertimin e mureve rrethuese	5,400	0		5,400

2312117	Terrenet sportive	41,599,732	55,600,012		97,199,744
2312118	Shpenzime per rritjen e AQT-te tjera ndertimore	27,678,912	24,829,206	52,508,118	0
2313100	Shpenzime per rritjen e AQT-konstruksione te rrugeve	40,507,291	39,953,515	76,565,684	3,895,122
2313200	Shpenz. Per rritjen e AQT-konstruksione te urave	0	0		0
2313300	Shpenz. Per rritjen e AQT-konstruksione te rrjeteve	397,362,401	939,413,378	52,218,854	1,284,556,925
2313400	Shpenz. Per rritjen e AQT-konstruksione te veprave ujore	0	46,149,992		46,149,992
2313500	Shpenz. Per rritjen e AQT-konstruksione te veprave ujore	0	0		0
2313600	Te tjera per konstruksionin e rrugeve, rrjeteve, veprave ujore	29,919,424	50,041,489	21,167,931	58,792,982
2314320	Shpenzime per rritjen e AQT- pajisjedhe makineri per ndert	0	0		0
2315120	Makina	0	0		0
2318100	Shpenz. Per rritjen e AQT-orendi zyre	25,000	3,994,200	3,994,200	25,000
2318600	Shpenz. Per rritjen e AQT-pajisje kompjuteri	78,000	0		78,000
	totali 230-231	603,083,834	1,256,936,583	229,271,380	1,630,749,036

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtoria e Financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2023.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6, 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika 6. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues,

Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", Pika 2.Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël). Nënpika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2, Paragrafi - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata jo materiale".

Pika 33. Llogaritë përkatëse në klasën 2 funksionojnë si më poshtë vijon:

a) Për shtesat nga rivlerësimi:

Do të debitohen llogaritë e klasës 2 të aktiveve afatgjata, dhe

Do të kreditohet llogaria 109 “Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Pogradec më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

65	B	PASIVET(DETYRIMET)	544,244,577	608,315,816
66		I.Pasivet Afat shkurtra	544,244,577	608,315,816
67		1. Llogari te Pagushme	539,160,777	602,887,116
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	147,725,695	275,720,140
69	42	Detyrime ndaj personelit	15,027,116	14,324,785
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	2,088,586	1,968,355

73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	22,902,333	22,677,439
76	436	Sigurime Shendetstore	3,166,177	3,136,553
77	437,438,	Organizma te tjere shtetore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	138,122,997	78,696,639
82	467	Kreditore te ndryshem	46,383,532	62,988,996
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	163,744,341	143,374,209
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 147,725,695 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 275,720,140 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 15,027,116 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhën në Janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën kontabël 2,088,586 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhën në janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 22,902,333 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhën në janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2023 është në vlerën kontabël 3,166,177 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhën në janar të vitit 2024.

Shënim: Diferenca në vlerën 21,007,563 lekë janë detyrime të palikuiduara të Klubit Shumë Sportësh. Aktualisht KSHS është në proce gjyqësor me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve në Gjykatën e Apelit Pogradec.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Pogradec më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 78,696,639 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 138,122,996 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, por mungojnë të dhënat e esenciale si data e hyrjes, data e përfundimit të afatit të garancisë. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshur, Kap. III, pikat 30, 50.*

Pika 30. “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë

e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50. “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Në menyrë të detajuar lista që disponon Drejtoria e financës paraqitet në aneksin nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të paqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në aneksin nr. 6 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 1,696,259,336 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Pogradec paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 197,801,105 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 449,662 lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël , e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **702 “Tatim mbi pasurinë”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 63,922,060 lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **703 “Tatime mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 133,387,333 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj., e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 137,133,586 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 15,458,610 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 121,663,061 lekë, e cila përfshin tarifën e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2023 , të cilat në total janë në vlerën 1,568,668,721 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën **221,640,607 lekë** dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën **221,640,607 lekë** diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën **36,263,533 lekë** dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën **36,263,533 lekë** , diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën **249,414,373 lekë** dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën **249,414,373 lekë** , diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën **99,899,910 lekë** dhe sipas aktrakordimit me Thesarin
- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën **1,000,528,928 lekë**, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Për vitin 2023 totali i të ardhurave është në vlerën **1,696,259,336 lekë** dhe totali shpenzimeve është **1,568,668,721 lekë**. Diferenca e tyre në vlerën **127,590,645 lekë** rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2023 është në vlerën - **39,078,630 lekë** .

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj... Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2023 numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. **15** datë **20.01.2023**. Miratuar në total numri **760** punonjës nga të cilët 310 janë punonjës të Bashkisë Qëndër, Njësitë Administrative dhe MZSH, 130 punonjës janë të Ndërmarrjes së Mirmbajtjes së Infrastrukturave dhe punëve publike, 70 punonjës janë të Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit si dhe 250 punonjës janë të Qendrës Arsimore. Referuar listëpagesave të muajt dhjetor 2023 nuk u konstatua tejkalim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Pogradec , është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve Janar 2024 dhe Dhjetor 2023 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës I. K. dhe nga Specialistet e pagave.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë z. I. X.

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore dhe nga Kryetari Bashkisë z. I. X.

B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2023.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar 2023 dhe Dhjetor 2023) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Pogradec, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH".

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Pogradec, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar 2023 dhe Dhjetor 2023) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Veprimet nëpërmjet magazinës

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhet në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara.

- Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Sa me sipër për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. I. X. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. I. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe znj. A. S. me detyrë përgjegjëse në Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.

2.4. Auditimi mbi Organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet, Kullotat) të transferuara me VKM.

Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Pogradec

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: për vitin 2023 struktura organizative është miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr.15 ,datë 20.01.2023”Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin të pozicioneve të punës të bashkisë Pogradec, njësisve administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2023” është krijuar sektori i administrimit të aseteve, statistikës dhe menaxhimit të performancës.

Me VKM nr. 1240, datë 10.9.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Pogradec, të Qarkut Korçë”, i është miratuar lista inventarit me nr. rendor 297 prona. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB-në nr.18, datë 09.04.2003 ”Mbi miratimin e listës së inventarit të pronave publike shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi të Bashkisë Pogradec”, Këshilli Bashkiak ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë me nr rendor 297. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr.rendor 297 (dyqind e nëntëdhjetë e sipas listës së inventarit bashklidhur, gjithsej 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Nga këto 142 (njëqind e dyzet e dy) në pronësi, 1 (një) në përdorim.

Ish Komunës Çërravë, sot Njësia Administrative Çërravë, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr.417, datë 08.06.2011“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Çërravë, të qarkut të Korçës” i është miratuar lista inventarit me nr rendor 180 prona nga të cilat 83 prona në pronësi dhe 9 prona në përdorim.

Ish Komunës Dardhas, sot Njësia Administrative Dardhas, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr 7,datë 6.1.2011“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike,shtetërore,që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Dardhas, të qarkut të Korçës” i është miratuar lista inventarit me nr rendor 452 prona nga të cilat 96 prona në pronësi dhe 27 prona në përdorim.

Ish Komunës Buçimas,sot Njësia Administrative Buçimas,e Bashkisë Pogradec, me VKM nr.244,datë 4.4.2012 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike,shtetërore,që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Buçimas,të qarkut të Korçës” i është miratuar lista inventarit me nr rendor 372 prona nga të cilat 82 prona në pronësi dhe 15 prona në përdorim.

Ish Komunës Trebinjë,sot Njësia Administrative Trebinjë,e Bashkisë Pogradec, me VKM nr 278,datë 18.3.2009“Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike,shtetërore,që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Trebinjë, të qarkut të Korçës” i është miratuar lista inventarit me nr rendor 637 prona nga të cilat 139 prona në pronësi dhe 49 prona në përdorim.

Ish Komunës Udënisht,sot Njësia Administrative Udënisht, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr 534, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Udënisht, të qarkut të Korçës” i është miratuar lista inventarit me 300 prona nga të cilat 84 prona në pronësi dhe 27 prona në përdorim.

Ish Komunës Proptisht,sot Njësia Administrative Proptisht, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr 1329,datë 1.10.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Proptisht, të qarkut të Korçës” i është miratuar lista inventarit me nr .rendor 466 prona.

Ish Komunës Velçan, sot Njësia Administrative Velçan, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr. 243, datë 27.2.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Velçan, të qarkut të Korçës” i është miratuar lista inventarit me nr rendor 530 prona.

Mungojnë VKB-të nga Këshilli Bashkiak si dhe shkresat që duhet dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike

Sa më sipër rezulton se përsa i përket pronave të Kaluara me VKM në Njësitë Administrative dhe bashkin Pogradec konstatohet se nuk është bërë pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet, nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Pogradec, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunës, nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje, nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP (ASHK) për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë **27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III**, pika 30 ku citohet: *“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhtme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”* dhe pika 35/a ku citohet: *“Dokumentet vërtetues- vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet mandate arkëtimet, mandate pagesat, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.” si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV.*

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprime ngarkohet me përgjegjësi : **z. I. X.** Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues, **znj. I. K.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2022		Nr. Praktikave të Certifikuara deri dhjetor 2023		Prona të Rregjistruara
			Nr aplikime Ne ASHK	Nr certifikatash	Nr aplikime Ne ASHK	Nr certifikatash	
1	Bashkia Pogradec	642	60	18	154	68	488
2	NJA. Buçimas	285	73	63	116	106	169
3	NJA.Udënisht	132	10	10	15	15	117
4	NJA.Çërravë	142	-	-	6	6	136
5	NJA.Velçan	256	21	21	21	21	235
6	NJA.Dardhas	136	5	5	18	18	118
7	NJA.Trebinjë	231	-	-	41	41	190
8	NJA.Proptisht	334	23	23	28	28	306

Në mënyrë të përmblëdhur pronat e certifikuara per 2023 janë si vijon:

		TOTALI									
		Shuma Totale						Pasuri te leshuara me qera			
N R	Fusha e perdorimit te prones	sasi totale	m2,ml/ha	Sip. Nderi mi	Vlere fillestar e 000/lek	Regjistru ar gjithesej	Me certifikat e pasurie	sas i	M2	Vlere 000/lek	Shenime
1	Arsim	111	184232	34509	699684	11	10				
2	Bujqesi	353	14318.19	0	0	114	114	52	4E+06	7771	
a	Are	148	8324.48			85	85				
3	Ujitje-kullim	327		968	0						Truall 5375m2
a	Kanale	264	1702509	968	0						ml
b	Rezervuare + lumenj	63	1090780	0	0						
4	Shendeti publik	48	21535	4900	75584						
5	Mbrojtje	71	36825.41	5213.9	194	2					
6	Administrata	5	5855	3035	8272	1	1				
7	Pyje dhe Kullota	1447	26356.09	0	0	129	129	21		9102	
a	Pyll	1127	22104.76			116	116				
b	Kullote	254	3863.994			7	7			589	
c	Djerr	30	105.59								
d	Inprod.	20	117.96			5	5				
e	Shkembore	10	48.69			1	1				
f	Sip.Bimore	6	115.1								
8	Kulture sport	65	156307.48	5594.1	5653	7	2				
a	Kulture	57	20609.88	3903.6	900	4	1				
b	Sport	8	40197.6	1690.5	4753	3	1				
9	Rruget	730	13425975	0	0	75	14				13426 KM
10	Trotuare dhe sheshe	207	166871			16			3117	6578	56.6KM
11	Sherbim funeral	139	494554	32.92	0	1	1				
12	Parqe lulishte	81	360026.4	0	0	7			15620	11276	
13	Ujesjellesi	145	186838.2	5684.2	2611428	13	13				
14	Banim	40	3282.52	3282.5	0	40	32				
15	Troje	6	8557.6			6	4				
	TOTAL	3775				422	320	73			

Nga auditimi rezultoi se për periudhën janar- dhjetor 2023, Sektori i Administrimit të Aseteve ka aplikuar për regjistrimin e 124 (80+44) pasurive publike, me një sipërfaqe prej 2.701.734 m², nga të cilat 54 pasuri me sipërfaqe 20.913 m² janë infrastrukturë rrugore , 31 pasuri me sipërfaqe 2656 m2 janë pasuri që përdoren për banim, 1 pasuri me sipërfaqe 1862 m2, është aset që përdoret në fushën e kulturës , 2 pasuri me sipërfaqe 652 m2 janë asete që përdoren në fushën e mbrojtjes , 21 pasuri me sipërfaqe 603956 m2 janë tokë are, 12 pasuri me sipërfaqe 692500 m2 janë pyll , 3 pasuri me sipërfaqe 151050 m2 janë tokë e pafrytshme dhe 8 pasuri me sipërfaqe 1228145 m2 janë pemtore.

Në total janë certifikuar 320 prona sipas tabelës së sipërcituar të cilat nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar.

Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Pogradec në Drejtorinë rajoneve të ASHK pogradec, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 320 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Pogradec. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje

me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16)
Sa më sipër për veprimet dhe mosveprime ngarkohet me përgjegjësi: z. I. X. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. I. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.5. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

2.5.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.5.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH-së për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

2.5.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 522/13 datë 29.12.2023 i ka dërguar Bashkinë Pogradec, “Raportin përfundimtar” të auditimit. ,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, janë konstatohet që:

2.5.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

Në mbështetje të nenit 15, gërma “j”, të Li gjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Pogradec ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 32/2 prot., datë 24.01.2024, duke respektuar afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

2.5.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH-së për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

Në zbatim të nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Pogradec ka kthyer përgjigje në KLSH me anë të shkresës nr. 32/64 port., në datën 28.06.2024, në lidhje me masat korrigjuese të marra dhe të pranuarra për zbatimin e rekomandimeve të lëna duke respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr 522/13 datë 29.12.2023, janë rekomanduar gjithsej:

1. Janë rekomanduar 49 **masa organizative.**

2. Janë rekomanduar 10 **masa për shpërblim dëmi në vlerën 7,027,330 lekë.**

3. Janë rekomanduar 6 **masa për uljen e borxhit në vlerën 275,701,347 lekë.**

4. Janë rekomanduar 1 **masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.**

5. Janë rekomanduar 16 **masa disiplinore.**

IV. Statusi i pranueshmësisë së rekomandimeve të KLSH-së.

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Pogradec, me nr.35 prot., datë 04.01.2024, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	49 masa	11	2	5	31
2	Shpërblim dëmi	5 masa	4	0	1	0
3	Shpërblim dëmi (Auditimi i mëparshëm)	5 masa	2	0	0	3
4	Masa për uljen e borxhit	6 masa	0	4	1	0
5	Masa për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	1 masa	-	-	-	-
6	Masat disiplinore	16 masa	15	0	0	1

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve të pranura paraqitet si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec, si dhe Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Nga verifikimi rezultoi:

Kryetari i Bashkisë Pogradec në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve ka hartuar regjistrin e riksut me nr.1757/11 prot., datë 20.09.2023. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim është **i zbatuar**.

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit, administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

Nga verifikimi rezultoi:

Përfaqësuesit e Bashkisë Pogradec, nuk kanë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

1.3. Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit “Harta e proceseve të punës”.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe titullari i saj ka nxjerrë urdhërin nr. 667, datë 12.12.2023 për miratimin e planit për trajnimin e punonjësve për vitin 2024. Sektori i Burimeve Njerëzore ka përgatitur “Hartën e porceseve të punës” dhe në rregulloren e breëndeshme janë përacktuar qartë detyrat për cdo pozicion pune. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim është **i zbatuar**.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditit të Brendshëm, të marrë masa për:

-Certifikimin e audituesve të NJAB.

-Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Brenda datës 30.06.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, NJAB vendosi në dispozicion certifikatat “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” e dy specialisteve të NJAB, përkatësisht certifikata me Nr.Regjistri. 2127 për znj. P. A. dhe certifikata me Nr.Regjistri. 2094 për znj. E. P.. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit përgjegjshi i sektorit të NJAB ka kërkuar mbështetjen e Kryetarit të Bashkisë Pogradec dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm. Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është ngritur.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar pjesërisht**.

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Pogradec, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, NJAB në planifikimin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së saj për vitet 2024-2026, dërguar me shkresën nr.3893/1 pro., datë 12.10.2023 në Drejtorinë e harmonizimit dhe për auditin e brendshëm/ Ministria e Financës, ka planifikuar të auditojë cdo vit subjektet me risk të lartë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

2.3. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Pogradec, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, NJAB ka arkivuar dosjet e auditit në arkivin e institucionit. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Pogradec.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik.

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore dhe Përfundimtare të PBA-së.

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Pogradec.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, përfaqësuesit e saj për vitin 2023 buxheti bazë fillestar vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 144 prot., datë 28.12.2022. Konfirmuar nga institucioni i Prefektit të qarkut me shkresën nr. 5/1 port., datë 11.01.2023. Referuar vendimit të sipërcituar Bashkia ka argumentuar pjesërisht kërkesat buxhetore të cilat janë pasqyruar në programet ekonomike. Ky rekomandim konsiderohet **në proces**.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, përfaqësuesit e saj për vitin 2023 buxheti bazë fillestar vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 144 prot., datë 28.12.2022. Konfirmuar nga institucioni i Prefektit të qarkut me shkresën nr. 5/1 port., datë 11.01.2023. Referuar vendimit të sipërcituar Bashkia ka argumentuar pjesërisht kërkesat buxhetore të cilat janë pasqyruar në programet ekonomike. Ky rekomandim konsiderohet **në proces**.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Përgjatë vitit buxhetor 2024 dhe në vijim

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

5.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, në MFE.

Për çdo vit buxhetor

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj me anë të shkresës nr. 826/5 prot., datë 28.02.2024 i janë drejtuar Ministrisë së Financave në lidhje me detyrimet e prapambetura ndaj palëve të treta. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2024 dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka marrë masa për planifikimin sa më të saktë, real dhe të realizueshëm për planin e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. Kjo drejtori ka dërguar shkresa në institucionet për të marrë informacion.

Ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifatat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka marrë masa për secilin vit buxhetor duke mbajtur të ndara për efekt planifikimi të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura nga detyrimet vendore të vitit buxhetor aktual. Ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Pogradec të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka bërë rakordimet me agjentin tatimor (UK Pogradec) sipas shkresës nr. 20 prot., datë 23.01.2024. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim është **i zbatuar**.

8.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pogradec, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifatat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka bërë rakordimet me agjentin tatimor (UK Pogradec) për çdo muaj sipas shkresave të vendosura në dispozicion (Shkresa me nr.20 prot., 23.01.2023 e muajit Dhjetor bashk me tabelën përmbledhëse për vitin 2023) nuk kanë diferenca. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim është **i zbatuar**.

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të merren masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të taksave dhe tatimpaguesve vendore në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, me qëllimin ruajtjen dhe mirë administrimin e të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec , titullari i saj ka lidhur kontratën me nr. 615/15 prot., datë 25.05.2022 me kompaninë D. SH.P.K. për “Mirëmbajtje Program Kompiuterik Drejtoria e Tatimeve + IT”. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim është **i zbatuar**.

10.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Pogradec të merren masa për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave të qirasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, titullari i saj nuk kanë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

11.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimit të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

12.1. Rekomandimi: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve pas përfundimit të procesit të inventarizimit të paraqiten para nëpunësit autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, titullar i saj në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion ka ngritur komisionet për inventarizimet. Përkatësisht urdhëri nr. 574, datë 16.10.2023; urdhëri nr.583, datë 16.10.2023, urdhëri nr.582, datë 16.10.2023, urdhëri nr. 581, datë 16.10.2023, urdhëri nr. 580, datë 16.10.2023, urdhëri nr. 578, datë 16.10.2023, urdhëri nr. 579, datë 16.10.2023, urdhëri nr. 577, datë 16.10.2023, urdhëri nr.576, datë 16.10.2023 dhe urdhëri nr.575, datë 16.10.2023. Ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

12.2. Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e komisionit të inventarizimit me qëllim realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtori i Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për të marrë masë për zbatimin e rekomandimit. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

13.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Qendra Arsimore të marrin masa në të ardhmen që aktivet të cilat janë klasifikuara për transferim/dhurim drejt subjekteve private, të aplikohet procedura e ankandit duke zbatuar edhe njëkohësisht detyrimet ligjore të përcaktuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 108.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Qendra Arsimore për vitin 2023 ka nxjerrë urdhërin nr.3 datë 06.01.2023 ka ngritur komisionin për marrjen në dorëzim të aktiveve afat shkurtra dhe afat gjata dhe urdhërin nr.4 datë 06.01.2023 komisionin e vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe

afatgjata. Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata ka konstatuar se aktivet ishin në gjendje të mirë dhe për këtë arsye ka vendosur që të mos nxirren jashtë përdorimit asnjë nga aktivet. Ky rekomandim konsiderohet **në proces**.

13.2. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Qendra Arsimore të marrin masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullator ligjor për mbrojtjen e mjedisit.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Qendra Arsimore ka nxjerrë urdhërat e punës nr. 5, datë 06.01.2023 komisionin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatmesme dhe urdhërin nr. 27, datë 01.05.2023 krijimin e komisionit të asgjësimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata. Për vitin 2023 komisioni i inventarit fizik të aktiveve ka konstatuar se aktivet ishin në gjendje të mirë funksionale dhe për këtë arsye komisioni ka vendosur të mos nxirren jashtë përdorimit asnjë nga aktivet. Ky rekomandim konsiderohet **në proces**.

14.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Pogradec të merren masa të menjëhershme për ngritjen një grupi pune i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale **5,424,007 lekë** për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 2,904,812 lekë, llogarinë 215 “Mjete transporti” në vlerën 1,729,695 lekë dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 789,500 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues nga NMIPP Pogradec. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të diferencave në inventar nga personat përgjegjës.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, titullari i saj nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

15.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të sistemojë llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”, duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të kategorisë privat dhe familjar.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

16.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë dhe Njësi Shpenzuese.

Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, përfaqësuesit e saj nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

16.2. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës

1,071,578 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

17.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

18.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për aplikimin e normës së amortizimit për llogarinë 215 “Mjete transporti” në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

19.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e kontabilizuar si të dëmtuara në llogarinë 24 “Aktive të dëmtuara” në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar nuk kanë marrë masa për zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

20.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për llogarinë 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” dhe llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” të kontabilizuara në vite, për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar nuk kanë marrë masa për zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

21.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

22.2. Rekomandimi: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndo shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 62,988,996 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar nuk kanë marrë masa për likuidimin e pagesave të palikujduara dhe zbatimin e rekomandimin. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

23.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve, Bashkia Pogradec, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e më parë, për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit për mungesë dokumentacioni ligjorë, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Pogradec, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Për garancitë e të cilat janë brenda afatit ligjorë, në momentin e përfundimit të afatit t'i kërkohej subjekteve zbatuese paraqitja e dokumentacionit ligjorë dhe pas verifikimit të punimeve të behet likuidimi i garancive.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, mungojnë rregulla të shkruara dhe kriteret për zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe rregulla lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë për punonjësit e Bashkisë Pogradec të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, "Mjedisi i kontrollit të brendshëm". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të hartojë rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk kanë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

25.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa që, emërimet e nëpunësve civilë të kryhen në zbatim të kriterëve të pozicionit të punës duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse për vitin 2023 kanë kryer 5 emerime që rregullojnë marrëdhëniet e punës me ligjin nr.152/2019 “Për nënpunësin civil”. Arsimi i lartë i personave të emëruar është në përputhje me kriteret e pozicionit të punës. Ky rekomandim konsiderohet **në proces**.

26.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Komisioni i blerjeve të vogla, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, titullari i saj dhe Komisioni i blerjeve të vogla nuk kanë vendosur në dispozicion dokument justifikues për zbatimin e rekomandimit. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

26.2. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor për 10 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga komisioni i blerjeve të vogla të përllogariten penalitetet përkatëse dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, titullari i saj dhe Komisioni i blerjeve të vogla nuk kanë vendosur në dispozicion dokument justifikues për zbatimin e rekomandimit. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

27.1. Rekomandimi: DPKZHT dhe Bashkia Pogradec të marrë masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon.

Të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, DPKZHT nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

28.1. Rekomandimi: DPZHTS Pogradec të marrë masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t’u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Gjithashtu, DPZHTS Pogradec, të shqyrtojë me përparësi të gjitha kërkesat e parashtruara nga këto autoritete dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi deri në plotësimin e kërkesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, DPKZHT nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

29.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Pogradec të marrë masat për:

-Të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. DPKZHT dhe Bashkia Pogradec të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, brenda afateve të përcaktuara në ligj.

-Shqyrtimin e vetëm atij dokumentacioni që kalon përmes sistemit elektronik të lejeve, të kërkojnë nëpërmjet këtij sistemi plotësimin e dokumentacionit, në të kundërt të refuzojnë kërkesat për pajisje me leje, duke respektuar afatet dhe dispozitat ligjore.

-Të marrë në konsideratë vetëm ato dokumente të projektit ndërtimor, të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve të cilat janë të nënshkruar elektronikisht nga hartuesit e tyre ose aplikanti.

-Të kontrolluar nëse dokumentet e pronësisë për parcelat në zhvillim, konkretisht kartelat e pasurive të paluajtshme, janë të rifreskuara sipas afateve të përcaktuara në ligj, në të kundërt, të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi që nuk i respekton këto përcaktime.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

30.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, IMTV dhe DPKZHT të marrin masa dhe të përdorin të gjithë instrumentet për të kryer kontrollet e nevojshme deri në marrjen e sigurisë së plotë se objektet për të cilat aplikohet për leje zhvillimi/ndërtimi nuk kanë filluar ndërtimin pa marrë miratimet e nevojshme sipas ligjit. Këto struktura duhet të rrisin bashkëpunimin midis tyre me qëllim krijimin e kushteve për një zhvillim të kontrolluar të territorit. Gjithashtu, përpara miratimit të lejeve të përdorimit, DPKZHT dhe IMTV duhet të bashkëpunojnë duke ushtruar aktivitetin e vet inspektues mbi dokumentacionin e dorëzuar në sistemin elektronik të lejeve, si dhe duke inspektuar në terren, për të marrë siguri të lartë mbi zbatimin e objekteve sipas projekteve të miratuara.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

30.2. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, DPKZHT dhe IMTV të marrin masa për të mos lejuar vendosjen në përdorim të objekteve të cilat nuk janë pajisur me leje përdorimi. Për çdo rast të konstatuar, këto autoritete duhet të ushtrorjnë aktivitetin e tyre duke marrë masat e parashikuara në ligj përkundrejt këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

31.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor me arsim të lartë, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim rritjen e efektivitetit të punës inspektuese të kësaj strukture.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë arrë asnjë masë për plotësimin e strukturës me inspektorë me arsim të lartë sipas parashikimeve ligjore. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

32.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec, të marrë masat që për çdo rast të konstatuar në shkelje të lejes së ndërtimit ose në mungesë të saj, të ndërmarrin të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e kundërvajtësit, si dhe kthimin në gjendjen fillestare të objektit të kundërligjshëm kur parashikohet në ligj, nxjerrjen e vendimit për pezullimin e punimeve për ato raste kur kundërvajtësi ka nevojë për kohë sipas përcaktimeve për plotësimin e dokumentacionit ligjor, vendosjen e masave administrative ndëshkim me gjobë në raport të drejtë me shkeljen e konstatuar, nxjerrjen e vendimit të prishjes, ndërmarrjen e hapave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësin dhe për heqjen e licensave profesionale për profesionistët përgjegjës, si dhe të kërkojë pranë gjykatës administrative nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për ato raste kur gjobat nuk paguhen brenda afateve, të gjitha këto në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda afateve të parashikuara.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

32.2. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planeve të punës në mënyrë periodike, çdo muaj, sipas zonave të kontrollit, me qëllimin rritjen e efektivitetit të punës inspektuese dhe garantimin e zhvillimit të kontrolluar të territorit.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

32.3. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec, të marrë masa për rritjen e bashkëpunimit me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe hartimin e raportimeve çdo tre muaj mbi aktivitetin e IMTV, me qëllimi rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional, marrjen e asistencës për të gjitha rastet kur është nxjerrë vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nga ana e IMTV, si dhe vendosjen në dijeni të IKMT për të gjithë veprimtarinë e saj.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

32.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec të merren masa për të bërë të mundur përlllogaritjen, kontabilizimin dhe aplikimin e kamat-vonesave, për të gjithë kundërvajtësit që nuk i paguajnë gjobat brenda afateve të parashikuara, me qëllim ndëshkimin në raport të drejtë të kundërvajtësve, si dhe aplikimin e masave shtrënguese.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

33.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi:

Titullari i institucionit ka miratuar plan veprim me nr. 32/2 prot., datë 24.01.2024 për zbatimin rekomandimeve të lëna nga raporti përfundimtar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, po zbatimi i këtij

plani veprimi nga drejtorinë dhe sektoret përkatës ka qënë shume i ulët. Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar **pjesërisht**.

MASA ORGANIZATIVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

2.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për forcimin e procesit të auditimit të brendshëm duke planifikuar auditime në sektorë me risk të lartë dhe të rrisë numrin e auditimeve në Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, NJAB në planifikimin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së saj për vitet 2024-2026, dërguar me shkresën nr.3893/1 pro., datë 12.10.2023 në Drejtorinë e harmonizimit dhe për auditin e brendshëm/ Ministria e Financës, ka planifikuar të auditojë cdo vit subjektet me risk të lartë dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

2.2 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë të marrë masa, për trajnim stafit të NJAB dhe bazuar në rezultatet të hartojë Planin e Zhvillimit Profesional të nëpunësve duke planifikuar marrjen pjesë të nëpunësve rregullisht në trajnimet e ofruara nga Ministria e Financës (Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm) apo ASPA si dhe të vlerësojë mundësitë e organizimit të trajnimeve brenda institucionit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe titullari i saj ka nxjerrë urdhërin nr. 667, datë 12.12.2023 për miratimin e planit për trajnimin e punonjësve për vitin 2024. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Sektorët e tjerë në Bashkinë Pogradec, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Zbatimi i këtij rekomandimi është trajtuar në akt konstatimin nr.4 datë 18.10.2024.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës dhe sidomos për personat që janë larguar nga puna dhe kanë fituar të drejtën e zhdëmtimit, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike ka bërë raportimin në MFE me shkresën nr. 826/5 prot., datë 28.02.2024 në të cilën janë pasqyruar detyrimet e prapambetura. Ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa që në vazhdimësi të realizojnë në kohë ngritjen e komisioneve për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të papërdorshme, për të krijuar hartimin me saktësi të pasqyrave financiare në fund të vitit ushtrimor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2022.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në mungesë të informacionit periodik nga ASHK mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë saj, të angazhohet në kryerjen e verifikimeve periodike në terren për të përditësuar dhe saktësuar informacion dhe të dhënat mbi pronësinë dhe sipërfaqen e ndërtesave të cilat duhen për llogaritjen e taksës së ndërtesës. Gjithashtu, DTTV nga ana e saj, të vazhdojë të ndjekë në rrugë institucionale për të marrë informacionin periodik nga ASHK në zbatim të kërkesave të VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018, “Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec , Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka dërguar kërkesën me nr.464 prot., datë 26.01.2024 për informacion periodik nga ASHK për pasuritë e paluatjshme të regjistruar pranë saj, për të përllogaritur taksën e ndërtesës.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim është pjesërisht **i zbatuar**.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të kryejë verifikime në terren si dhe në faqet e internetit që ofrojnë rezervime për akomodim në territorin e Bashkisë Pogradec, për të identifikuar njësitë akomoduese që ushtrojnë aktivitetet të pa regjistruar duke i'u shmangur pagesës së taksës së fjetjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec , Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka bërë verifikimet në terren në bazë të urdhërave të ngritur sipas shkresave me (nr.342 prot., datë 06.06.2022 dhe nr.342/1prot., datë 06.06.2022.) Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim është **i zbatuar**.

8.1 Rekomandimi: Policia Bashkiake të dërgojë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar rregullisht listat e kundërvajtësve që nuk kanë paguar gjokat e vendosura. Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të kryejë kontabilizimin në përputhje me kërkesat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Zbatimi i këtij rekomandimi është trajtuar në akt konstatimin nr.6 datë 18.10.2024.

9.1 Rekomandimi: Policia Bashkiake në bashkëpunim dhe në konsultim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve të identifikojnë dhe zbatojnë mekanizma ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake bazuar në faktin që vjelja e tyre në faturën e ujit të pijshëm është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Deri më datë 30.06.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Policia Bashkiake nuk ka marrë asnjë masë për arkëtimin e gjobave të vendosura. Ky rekomandim është **i pa zbatuar**.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar bazuar në informacionin periodik vjetor të dërguar nga DTTV si dhe konform përcaktimeve të VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kapitulli 1, pika 2.3, të regjistrojë në kontabilitet detyrimet e subjekteve debitorë ndaj bashkisë për taksat dhe tarifat vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Nga auditimi i llogarisë nr.468 rezultoi se drejtoria e financës ka kontabilizuar vetëm debitorët e biznesit të vogël dhe të madh. Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar **pjesërisht**.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore/Njësia për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave të hartojë rregullisht dhe me saktësi listat e debitorëve progresiv si për subjektet fizik/juridik ashtu edhe për familjet debitorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka hartuar listën e subjekteve debitoare për vitin 2023. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion niveli i debisë gjendje 31.12.2023 për abonentët familjarë është në vlerën 143,834,560 lekë, ndërsa borxhi tatimor për subjektet fizikë/juridik është në vlerën 70,107,923 lekë. Ky rekomandim konsiderohet **në proces**. (për më hollësisht trajtuar në akt kostatimin për të ardhurat).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të zbatojë plotësisht kërkesat e përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 2,3,4,5 si dhe ti referohet Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, pika 77.4, gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë si dhe të monitorojë me shumë përgjegjësi zbatimin e kushteve të akt marrëveshjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka lidhur “Marrëveshje për pagesë me kështë të detyrimeve tatimore” me tatimpaguesit debitorë, si dhe ka monitoruar pagesat mujore të tatimpaguesve deri në shlyerje e detyrimeve. Ky rekomandim konsiderohet **në proces**.

13.1 Rekomandimi: Bashkia Pogradec të përfshijë në objektivat e saj krijimin e një sistemi me qëllim menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë sa më efektive dhe të saktë. Menaxhimi i taksave dhe tarifave vendore me anë të sistemit do të përmirësonte performancën e specialistëve të DTTV, do të ndikonte në uljen e gabimeve, mbrojtjen nga humbja e të dhënave si dhe në rritjen e të ardhurave në buxhetin e bashkisë.

Deri më datë 31.06.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, titullari i saj ka lidhur kontratën me nr. 615/15 prot., datë 25.05.2022 me kompaninë D. SH.P.K. për “Mirëmbajtje Program Kompiuterik Drejtoria e Tatimeve + IT”. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim është **i zbatuar**.

14.1. Rekomandimi: Të merren masa të menjëhershme për rishikimin e projekt-preventivit nga palët: Sipërmarrësi i punimeve “R.” SH.P.K. & “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1779/12 prot., datë 17.09.2020, të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit të “Rruga e Mokrës” nga Mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Bashkia Pogradec në cilësinë e AK, për zërat e punimeve: “Shtresë stabilizanti t=5cm”, “FV tub p.v.c shkarkim Ø 80 mm”, “FV tub p.v.c shkarkim Ø110 mm” dhe “FV tub fleksibël Ø 40;60 mm me tel bari në të” si zë i përsëritur në preventivin e projektit. Gjithashtu, mbikëqyrësi i punimeve t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve plotësimin e dosjes teknike me dokumentet: (Plan-organizimin e punimeve të ndërtimit; Ndryshimet në projekt- preventiv dhe miratimin e tyre nga AK; Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve; Librezën e masave; Situacionet mujore pjesore dhe progresive; Proces verbalet e miratimit të materialeve; Ditarin e objektit; Pasqyrën e realizimit të punimeve; Procesverbalet e punimeve të maskuara; Provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, si: hekur, beton, etj; Dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse; Çertifikat e cilësisë së materialeve).

Nga verifikimi rezultoi:

Nuk është vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit. Ky rekomandim do të konsiderohet i **pa zbatuar**.

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojë me Drejtorinë e Mbrojtjes së Tokës për evidentimin e të gjitha familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës së tokës bujqësore si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Pogradec në shumën 2,533,050 lekë.

Deri më datë 31.06.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka marrë listat nga Drejtoria e Mbrojtjes së Tokës për evidentimin e të gjithë familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, por nuk ka bërë planifikim të saktë për shkak se një pjesë e personave pronar nuk jetojnë me dhe nuk është celur trashëgimia. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim është i **zbatuar pjesërisht**.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec, të angazhohet në marrjen e masave dhe identifikimin e mekanizmave për pagesën e taksës së tokës bujqësore për familjet që nuk e paguajnë atë nëpërmjet agjentit tatimor UK Pogradec, por dhe ato familje që paguajnë në faturën e ujit të pijshëm, me qëllim rritjen e arkëtimit për taksën e tokës nga familjet debitorë në vlerën 5,251,748 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për familjet e pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore, të cilët nuk kanë kontratë me agjentin tatimor “Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Pogradec sh.a.” arkëton vlerën e taksës së tokës bujqësore kur këta individë kërkojnë “Vërtetim për shlyerje të detyrimeve vendore” për të kryer shtije ose tjtësim të tokës bujqësore. Ky rekomandim konsiderohet i **zbatuar pjesërisht**.

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për 329 subjekte debitorë me vlerë 32,646,254 lekë. Gjithashtu nga strukturat e Bashkisë Pogradec të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Zyra Vendore Pogradec për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Deri më datë 30.06.2024 dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Takave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nuk kanë sjellë dokumentacion justifikues për zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

19.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec, të intensifikojë punën dhe të marrë masa konkrete për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të familjeve për tarifat e pastrim-gjellbërimit-ndriçimit në vlerën 37,175,931 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Takave dhe Tarifave Vendore nuk kanë sjellë dokumentacion justifikues për zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

20.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, të kërkojnë në Gjykatë, shndërrimin e 20 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative” dhe të marrë masa për arkëtimin e gjobave të pa paguara për vitet 2019-2020 në vlerën 13,136,000 lekë. Gjithashtu, Inspektorati i Mbrojtës së Territorit të dërgojë në Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar rregullisht listat e kundërvajtësve ndaj të cilëve janë vendosur gjoba. Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të marrë masa për të bërë kontabilizimin e menjëhershëm të gjobave të vendosura ndaj shkelësve të ligjit në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kapitulli 1, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të matjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Inspektorati i Mbrojtës Territorit dhe Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

21.1 Rekomandimi: Policia Bashkiake të bëjë përpjekje në bashkëpunim dhe në konsultim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve të identifikojnë mekanizma ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave të Policisë Bashkiake në vlerën 141,000 lekë.

Deri më datë 31.03.2024 dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Policia Bashkiake nuk ka marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës 141,000 lekë. Ky rekomandim është i **pa zbatuar**.

22.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore/Njësia për Menaxhimin e Borxhit dhe Mbledhjes së të Ardhurave për debitorët e vitit 2019 të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrave që ka nxjerrë “Për vendosjes së masës siguroese apo barrës hipotekare, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshme” dhe “Për bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorë”.⁴ Për subjektet fizik/juridik që nuk kanë paguar detyrimet e vitit 2020 apo rezultojnë debitorë ndër vite në vlerën **44,428,186 lekë**, të ndiqen hapat e duhur ligjor sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për pagesën e detyrimeve si: Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit, Masa e sigurimit të detyrimit tatimor, Sekuestrimi i pasurisë”. Për subjektet fizik/juridik që nuk kanë paguar detyrimet e vitit 2020 të ndiqen hapat e duhur ligjor sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për pagesën e detyrimeve si: Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit, Masa e sigurimit të detyrimit tatimor, Sekuestrimi i pasurisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

⁴ Urdhër nr. 248, datë 07.04.2020, dhe Urdhër nr. 814, datë 13.10.2020, “Për vendosjes së masës siguroese apo barrës hipotekore, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshme”, Urdhër nr. 250, datë 07.04.2020, dhe Urdhër nr. 813, datë 13.10.2020, “Për bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorë”, Urdhër nr. 249, datë 07.04.2020, dhe Urdhër nr. 815, datë 13.10.2020, “Për vendosjes së masës siguroese apo barrës hipotekore, ndaj pasurive të luajtshme e të paluajtshme”.

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

23.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të rrisë bashkëpunimin me Agjentin Tatimor UK Pogradec për arkëtimin e të ardhura të mbledhura për llogari të bashkisë duke bërë të mundur arkëtimin e vlerës 13,624,890 lekë, dhe në rast të lindjes së problemeve të zbatojë procedurat ligjore për penalizmin e Agjentit Tatimorë sipas Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 117.

Deri më datë 31.06.2024 dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

24.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të vijojë ndjekjen e procedurave ligjore kundrejt subjektit “N.” SH.P.K. deri në përfundim të ankimimit dhe të marrë masat e duhura shtrënguese për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimit që subjekti ka ndaj bashkisë në vlerën totale 340,451 lekë.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues. Ky rekomandim është i **pa zbatuar**.

25.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet “H.” dhe “Gora” për adresën në Buçimas, të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë në zbatim të kërkesave të VKM-së nr. 344, datë 19.04.2017, kreu II, pika 9. Periudha e fillimit të autorizimit duhet të përkojë me afatin kur ka përfunduar autorizimi i fundit me qëllim që të bëhet e mundur edhe arkëtimi i vlerës prej **2,083,266 lekë** që përfaqëson detyrimin për periudhën e ushtrimit të aktivitetit pa autorizim”.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

26.1 Rekomandimi: Sektori i Monitorimit të Kontratave, Evidentimit dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të angazhohen që subjektet qiramarrëse të zbatojnë me përpikmëri kushteve e kontratave të qirasë me qëllim arkëtimin e detyrimeve në shumën 6,598,996 lekë.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimin e lënë për vitin 2023.

27.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Pogradec, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumen dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kriterë sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimin e lënë për vitin 2023.

28.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH- ja me shkresën nr. 360/60, datë 22.10.2019, “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Pogradec”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës. Të hartohet plan pune i veçantë e të marren të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Menjëherë

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, në bashkëpunim Sektorët e tjerë në Bashkinë Pogradec, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit korent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të viteve paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

2.2. Rekomandimi: Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizmit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të pa likuiduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbime dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Pogradec.

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

2.3. Rekomandimi: Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshirë kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të pa likuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

4.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Pogradec, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

4.2. Rekomandimi: Planifikimi i të ardhurave të kryhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

4.3. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, Sektori i Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

5.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Pogradec, të merren masa për rishikimin e strukturës së punonjësve me qëllim eliminimin e strukturave të panevojshme, uljen e numrit të punonjësve dhe për rrjedhojë uljen e shpenzimeve për paga, si dhe të rishikojë kontratat e lidhura në vitet e mëparshme me burim financimi të ardhurat Bashkisë Pogradec.

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

5.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, Sektori i Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrë masa që për investimet e reja me burim financimi të ardhurat e bashkisë, të mbështetet në një plan real, në marrjen e angazhimeve buxhetore, të cilat prekin edhe periudhat e ardhshme buxhetore dhe bëhen shkas për krijimin e situatave të vështira financiare dhe për rrjedhojë mos financim në masën dhe kohën e duhur të këtyre angazhimeve.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit Pyjor, të marrin masa të ngrihet grup pune për të kryer verifikimin në terren të subjekteve të cilat janë pajisur me leje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fondin pyjor dhe kullësor të Bashkisë Pogradec.

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

6.2. Rekomandimi: Për këto subjekte të evidentuara zona e lejuar e shfrytëzimit të hiqet nga fondi pyjor dhe kullësor dhe të kalojë si pasuri minerare në varësi të ministrisë së linjës.

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

6.3. Rekomandimi: Deri në momentin e heqjes nga fondi pyjor i Bashkisë Pogradec, të merren masa për të lidhur kontratat me subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shfrytëzimit me karrierë të mineraleve ndërtimore.

Afati 3 muaj

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme, për të kryer rakordim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me detyrimet debitore të lindura nga mos pagesat e taksave dhe tarifave vendore dhe të pa kontabilizuar për shumën 57,139,720 lekë, si dhe të kryej kontabilizimin e tyre, pas rakordimit, me qëllim paraqitjen e drejtë të kësaj llogarie (468 “Debitorë të ndryshëm”) në Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2024

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

8.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Pogradec, duhet të marrë masa për analizimin e situatës, përlllogaritjen e kostos për realizimin e këtij shërbimi, planifikimin në buxhet, si dhe nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së, të pasurive të paluajtshme, në emër të Bashkisë Pogradec.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

13.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, të marrë në analizë rezultatet e auditimit mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë, pasi për shkak të moszbatimit të tyre në 5 raste, edhe në auditimin e radhës janë evidentuar shkelje, mangësi, si dhe veprime, në kundërshtim me kriteret e vlerësimit, të cilat janë të përsëritura. Nga ana e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec, t’i kërkohet Kryetarit të Bashkisë, marrja e masave për shqyrtimin, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, në auditimin e mëparshëm, të cilat rezultojnë të pa zbatuara apo të zbatuara pjesërisht, të trajtuara rast pas rasti, në mënyrë të hollësishme në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi:

Ky rekomandim është trajtuar në rekomandimet e lëna për vitin 2023.

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **490,380** lekë pa TVSH nga Kontraktori “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot., datë 20.07.2018, me objekt “Sistemim rrugësh blloku Goricë”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **69,600** lekë pa TVSH nga Kontraktori “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot., datë 20.07.2018, me objekt për një shtesë fondi në kontratë “Sistemim rrugësh blloku Goricë”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **652,543** lekë pa TVSH nga Kontraktori “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1757/15 prot., datë 14.09.2020, të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit “Rruga e Kabashit”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, nuk ka vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **633,295** lekë pa TVSH nga Kontraktori “Sh.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4964/3 prot., datë 18.07.2019, të kontratës me objekt “Rehabilitim i shkollës mesme “Gjergj Pekmezi”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj kanë ndërmarë të gjithë hapat ligjor për arkëtimin e vlerës prej 633,295 lekë pa TVSH nga OE “Sh.” SH.P.K.. Sipas vendimit nr. 1138-(156), datë 19.05.2023 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Korce, bashkia Pogradec ka fituar gjyqin ndaj OE dhe ky vendim është apeluar nga OE. Në kushte të tilla ky rekomandim është i **zbatuar**.

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **793,871** lekë pa TVSH nga BOE “I.” SH.P.K. & “Sh.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7137 prot., datë 28.09.2019, të kontratës me objekt: “Sistemim blloku tek ish ferma Loti I”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj kanë ndërmarë të gjithë hapat ligjor për arkëtimin e vlerës prej 793,871 lekë pa TVSH nga BOE “I.” SH.P.K. & “Sh.” SH.P.K.. Sipas vendimit nr. 1140-(153), datë 19.05.2023 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Korce, Bashkia Pogradec ka fituar gjyqin ndaj BOE dhe ky vendim është apeluar nga BOE. Në kushte të tilla ky rekomandim është i **zbatuar**.

MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **224,926 mijë lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore, duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të Sektorit të bujqësisë, përfshirjen në planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore të shumës 3,084,700 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Brenda vitit ushtrimor 2024

2.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **9,600,000 lekë**, për subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë, për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, respektivisht për subjektet si më poshtë:

- Subjekti “H.” SH.P.K., për vlerën prej 800,000 lekë.
- Subjekti “A.” SH.P.K., për vlerën prej 800,000 lekë.
- Subjekti “S.” SH.P.K., për vlerën prej 800,000 lekë.
- Subjekti “E.” SH.P.K., për vlerën prej 800,000 lekë.
- Subjekti “B.” SH.P.K., për vlerën prej 2,400,000 lekë.
- Subjekti “G.” SH.P.K., për vlerën prej 800,000 lekë.
- Subjekti “O.” SH.P.K., për vlerën prej 800,000 lekë.
- Subjekti “G.” SH.P.K., për vlerën prej 2,400,000 lekë.

Brenda vitit ushtrimor 2024

3.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe Sektori i menaxhimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave, si dhe Nëpunësi zbatues, për 11 subjektet debitorë të krijuar si pasojë e shkeljes së detyrimeve kontraktuale nga ana e tyre, të merren masa për të ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e detyrimeve në shumën totale **22,798,289 lekë** deri në zgjidhjen e kontratës, sipas përcaktimeve të bëra në kontratë për këtë qëllim.

Brenda vitit ushtrimor

4.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për **339** subjekte në vlerën **26,359,607 lekë**; **6,040** familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **30,511,504 lekë** dhe debitorë nga toka bujqësore **4,915** familje në vlerën **2,526,710 lekë**, bazuar në neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor” ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime ne llogarit bankare.
- Ti dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se:

Për masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike të lëna në auditimin e mëparshëm do të konsiderohen në proces zbatimi pasi gjendja e tyre aktuale është reflektuar në akt kostatimin nr.5 datë 18.10.2024.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **182,540 lekë pa TVSH** nga OE “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3527/7 prot., datë 01.12.2020, me objekt “Sistemim i Odeonit në qendër të qytetit Pogradec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec nga fatura me nr. 105 datë 14.08.2024 që ka vendosur në dispozicion verifikojmë se ka bërë arkëtimin e vlerës 182,540 lekë pa TVSH nga OE “R.” SH.P.K.. Ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **335,316 lekë pa TVSH** nga BOE “M.” SH.P.K. & “B.” SH.P.K. & “A. K.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1596/8 prot., datë 14.07.2020, me objekt: “Ndërtimi i Ujësjiellit Udenisht-Memelisht, Pogradec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion kanë mbajtur vlerën prej 335,316 lekë me TVSH nga garancia prej 5 % që BOE ka depozituar. Kjo vlerë është mbajtur në urdhër shpenzimit me nr. 342 datë 20.06.2024. Ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,904,378 lekë pa TVSH** nga OE “V.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 767/19 prot., datë 14.06.2021, me objekt: “Rehabilitim i lagjes Gani Homçani”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj kanë përgatitur kërkesë padine me nr.4158/1 prot., datë 11.10.2024 për arkëtimin e vlerës prej 1,904,378 lekë pa TVSH nga OE “V.” SH.P.K. në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **235,972 lekë pa TVSH** nga OE “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1404/26 prot., datë 14.10.2021, me objekt: “Rehabilitimi i Rrugës e Rodokal Njësia Administrative Propisht”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec nga fatura me nr. 105 datë 14.08.2024 që ka vendosur në dispozicion verifikojmë se ka bërë arkëtimin e vlerës 235,972 lekë pa TVSH nga OE “R.” SH.P.K.. Ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera.

Dalja e përgjegjësive, mbi kryerjen e zërave të punimeve “Punime për ndarje e prurjes B-2 (D1)”, “Punime për pusët ajrimit” e “Punime për Pusetat e Shkarkimit” “Gërmim dheu me krahë bankinë kanali” sipas PZ dhe ST në shumën **4,369,124 lekë**, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec, sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve si dhe kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë. Në rast të kundërt, diferenca në

sasi dhe në vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Brenda datës 30.06.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, titullari i saj me shkresën nr.32/65 port., ka nxjerrë urdhërin nr. 451, datë 01.10.2024 për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin dhe analizimin e situatës lidhur me punimet e pakryera në objektin “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal i Mokrës (Faza 1)” sipas gjetjeve nga auditimi i KLSH.

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 228,158,142 lekë**.

- a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.
- b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
- d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
- e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB-në Bashkia Pogradec, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejin e tyre në debitorë të keq.
- f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka marrë masat për nxjerrjen e njoftimeve, dërgimin e urdhër bllokimeve të llogarive në banka, ka bërë kërkesa për vendosjen e barrës siguroese në Drejtorinë Rajonale të Transportit dhe ASHK. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **në proces**.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **27,062,037 lekë** ndaj **1,470** personave.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, DPKZHT nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Pogradec vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, DPKZHT nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në total në vlerën **2,308,968 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk kanë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi. Ky rekomandim është i **pa zbatuar**.

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 293.1 ha, duke aplikuar tarifat dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit **18,172,200 lekë** për 8 subjekte.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave Bashkia Pogradec, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pazbritura nga fondi pyjorë, t'i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjorë, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjorë", i ndryshuar, për zbritjen nga fondi pyjorë.

Deri më datë 31.03.2024

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Pogradec, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave nuk kanë vendosur në dispozicion dokumentacion justifikues për zbatimin e rekomandimit të lënë. Ky rekomandim konsiderohet i **pa zbatuar**.

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1-15. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2021-2022 në total janë realizuar 24 procedura prokurimi me fond limit **2,361,291 mijë lekë** pa TVSH dhe realizim kontrate **2,316,337 mijë lekë** pa TVSH. Referuar materialitetit të përcaktuar, grupi i auditimit nga 24 procedura ka vlerësuar për auditim **15** procedura me fond limit **2,152,752 mijë lekë** ose në masën **91%** të fondit limit.

Në **15** procedurat e audituara janë konstatuar shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, ku janë **aplikuar kritere** të paargumentuara dhe jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet e cila ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe mundësi për zbatimin e kontratës. Gjithashtu, mangësi janë konstatuar dhe në kualifikimin e OE/BOE me kritere të paplotësuar sipas kërkesave të DT dhe miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në 13 procedura për vlerën **2,264,536 mijë lekë pa TVSH, respektivisht:**

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rehabilitim/përforcim banesash ekzistuese kolektive 2021”** Bashkia Pogradec, Viti 2021, me fond limit **25,000 mijë lekë**, me fitues OE “I.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **18,784 mijë lekë**.
 2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rehabilitim i bllokut të banimit pranë rrugës Abdyl Frashëri”**, Bashkia Pogradec, Viti 2021, me fond limit **15,518 mijë lekë**, me fitues OE “V.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **15,417 mijë lekë**.
 3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rehabilitim i shesheve në dy krahët e unazës (Pranë Sot 7)”** Bashkia Pogradec, Viti 2021, me fond limit **9,775 mijë lekë**, me fitues OE “E.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **5,922 mijë lekë**.
 4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rehabilitim i rrugës së Rodokalit, Njësia Administrative Propisht”** Bashkia Pogradec, Viti 2021, me fond limit **58,333 mijë lekë**, me fitues OE “R.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **54,104 mijë lekë**.
 5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rehabilitim i lagjes Gani Homcani”** Bashkia Pogradec, Viti 2021, me fond limit **84,782 mijë lekë**, me fitues OE “V.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **84,238 mijë lekë**.
 6. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Ndërtim i Ujësellsit Rajonal Cerrave & Dardhas- Burimet e Gurrasit”**, Bashkia Pogradec, Viti 2021, me fond limit **775,722 mijë lekë**, me fitues OE “C.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **774,852 mijë lekë**.
 7. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Përfundimi i gjithë rrjetit të kanalizimeve te ujërave të ndotura në Njësinë Administrative Pogradec dhe Buçimas”, zhvilluar në 2020**, me fond limit **786,470 mijë lekë**, me fitues BOE “4.” SH.P.K. & “I.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **783,315 mijë lekë**.
 8. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Ujësjellësi i Mokrës Faza II” Bashkia Pogradec, zhvilluar në 2021**, me fond limit **221,972 mijë lekë**, me fitues BOE “R.” SH.P.K. & “A.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **220,000 mijë lekë**.
 9. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Ndriçim Rrugor (Rikonstruksion)”, Bashkia Pogradec, zhvilluar në 2021**, me fond limit **58,326 mijë lekë**, me fitues BOE “A.” SH.P.K. & “R.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **50,744 mijë lekë**.
 10. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion dhe shtesë shkolla e mesme “14 Ëngjëjt” dhe 9-vjeçare “Servet Agolli”, Buçima”**, Bashkia Pogradec, Viti 2021, me fond limit **116,850 mijë lekë**, me fitues OE “R.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **116,247 mijë lekë**.
 11. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rehabilitim dhe ambient shtesë, Këndi i Lojërave me dorë “Arefi Berberi”**, Bashkia Pogradec, Viti 2022, me fond limit **108,524 mijë lekë**, me fitues OE “V.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **108,363 mijë lekë**.
 12. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Furnizim-vendosje, shatërvan në qendër të qytetit (në liqen)”**, Bashkia Pogradec, Viti 2022, me fond limit **7,939 mijë lekë**, me fitues OE “A.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **7,140 mijë lekë**.
 13. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rehabilitim/Përforcim banesash ekzistuese kolektive 2022”**, Bashkia Pogradec, Viti 2022, me fond limit **25,000 mijë lekë**, me fitues OE “R.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **24,700 mijë lekë**.
 14. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i zyrave të Bashkisë”**, Bashkia Pogradec, Viti 2022, me fond limit **7,957 mijë lekë**, me fitues BOE “A.” SH.P.K. & “R.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **7,844 mijë lekë**.
 15. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rehabilitimi i skarpateve të lumit të qytetit”**. Bashkia Pogradec, Viti 2022, me fond limit **5,666 mijë lekë**, me fitues OE “B.” SH.P.K., me vlerë të ofertës **5,342 mijë lekë**, rezulton se në aplikimin e kriterëve të DT, janë vendosur kriteret të ekzagjuar dhe të paargumentuara.
- Kriteret e vendosura në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat

për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përzgjedhja e OE fitues është në shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe nenet 67 “Klasifikimi i ofertave”; 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”; 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” dhe 83 “Njoftimi i fituesit” të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqe 79-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Bashkia Pogradec, të marrin masa që:

- Në periudhat në vijim në lidhje me procedurat e prokurimit, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

- Për të gjithë procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera nuk duhet të hidhen në prokurim pa marrë më parë miratimin nga Instituti i Ndërtimit për oponencën teknike të investimit.

- Të bëhet inventarizimi dhe arkivimi i të gjitha dosjeve të mbyllura dhe arkivuara sipas të dhënave të sistemit të SPE.

- Të bëhen pjesë e dosjes së procedurës, DST, procesverbali i hapjes së procedurës, raporti përmbledhës dhe vendimi i titullarit të AK për shpalljen fitues.

Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Pogradec dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për një përdorim me efektiv të fondeve në vlerën **2,264,536 mijë lekë pa TVSH**.

Menjëherë

Nga verifikimi rezulton se:

Referuar programit të auditimit 1081/1 Prot., datë 11.09.2024, i ndryshuar nuk ka pasur në zbatim pikën e procedurave të prokurimit publik. Grupi i auditimit nuk mund të shprehet për zbatimin e këtij rekomandimi.

F. MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) të nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996, “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, nenit 12 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pogradec** të vlerësojë shkeljet të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për **15 (pesëmbëdhjetë)** punonjësit, si më poshtë:

A. “Vërejtje” për:

1. Znj. V. B., me detyrë specialiste për projektet inxhinierike dhe planifikimin e territorit pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT).

Nga verifikimi rezultoi:

Nuk është vendosur masë disiplinore për znj. V. B. pasi i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 11.06.2023 sipas urdhërit me nr. 284 datë 09.06.2023. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

2. Znj. M. K., me detyrë specialistit të kontrollit të dokumentacionit të kërkesave për pajisje me certifikatë përdorimi pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT).

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 62 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për znj. M. K.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

B. “Vërejtje me paralajmërim” për:

1. Z. P. Z., me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT).

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 69 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. P. Z.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

2. Z. T. F., me detyrë specialistit jurist pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT).

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 61 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. T. F.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

3. Znj. F. Z., me detyrë përgjegjëse e kontrollit të dokumentacionit të kërkesave për zhvillim pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT).

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 81 datë 12.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për znj. F. Z.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

4. Z. N. Ç., në funksionin e kryeinspektorit të IMT-së.

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 65 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. N. C.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

5. Z. V. M., në funksionin e ish-kryeinspektorit të IMT-së, për mos nxjerrjen e vendimit të prishjes në një rast; për moskryerje e raportimit tre mujor ndaj IKMT; për mos hartimin e planeve mujore për inspektorët; për mungesën e bashkëpunimit midis strukturave të mbrojtjes së territorit; për mos-kryerjen e kërkesave për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për vjeljen e gjobave të vendosura.

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 68 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. V. M.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

6. Z. R. Ç., në funksionin e ish-kryeinspektorit të IMT-së.

Nga verifikimi rezultoi:

Nuk është vendosur masë disiplinore për z. R. Ç. pasi i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 23.09.2023 sipas urdhërit me nr. 653 datë 23.09.2021. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

7. Z. K. Ç., në funksionin e ish-kryeinspektorit të IMT-së.

Nga verifikimi rezultoi:

Për punonjësin z. K. Ç. nuk është vendosur masë disiplinore. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.

8. Z. H. H., në funksionin e juristit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor;

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 60 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. H. H.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

9. Z. G. Sh., në funksionin e inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor;

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 63 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. G. Sh.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

10. Z. K. L., në funksionin e inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor;

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 64 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. K. L.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

11. Z. E. B., në funksionin e inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor;

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 67 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. E. B.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

12. Z. A. B., në funksionin e inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor;

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 82 datë 25.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. A. B.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

13. Z. G. Ç., në funksionin e inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor;

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 66 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. G. C.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

14. Z. L. B., në funksionin e ish-inspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor.

Nga verifikimi rezultoi:

Me anë të vendimit nr. 59 datë 05.04.2024 është vendosur masë disiplinore “Vërejtje” për z. L. B.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Pogradec pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecursë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi:

a. Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë njoftuar Departamentin e Administratës Publike për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personalet.

b. Bashkia Pogradec dhe përfaqësuesit e saj nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion kanë mbajtur komunikime të vazhdueshme dhe kanë njoftuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me zhvillimin/menaxhimin e proceseve të shërbimit civil. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar pjesërisht**.

- Konkluzione dhe rekomandime:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Pogradec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së paraqitur me shkresën e saj nr. 522/13 datë 29.12.2023,

për masat të cilat janë cilësuar në proces zbatimi rikërkohet përshpejtimi i realizimit të tyre dhe për masat e pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht KLSH rikerkon zbatimin e plotë të rekomandimeve, si vijon:

A Masa Organizative

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

10.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Pogradec të merren masa për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave të qirasë.

11.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimit të tyre.

12.2. Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e komisionit të inventarizimit me qëllim realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

14.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Pogradec të merren masa të menjëhershme për ngritjen një grupi pune i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale **5,424,007 lekë** për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 2,904,812 lekë, llogarinë 215 “Mjete transporti” në vlerën 1,729,695 lekë dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 789,500 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues nga NMIPP Pogradec. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, të diferencave në inventar nga personat përgjegjës.

15.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të sistemojë llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”, duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifat vendore të kategorisë privat dhe familjar.

16.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë dhe Njësi Shpenzuese.

Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

16.2. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 1,071,578 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

17.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

18.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për aplikimin e normës së amortizimit për llogarinë 215 “Mjete transporti” në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi.

19.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e kontabilizuar si të dëmtuara në llogarinë 24 “Aktive të dëmtuara” në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

20.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjore për nxjerrjen e të dhënave për llogarinë 28 “Caktime të Aktiveve Afatgjata” dhe llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” të kontabilizuara në vite, për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

21.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

22.2. Rekomandimi: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoj shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 62,988,996 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

23.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve, Bashkia Pogradec, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e më parë, për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit për mungesë dokumentacioni ligjorë, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Pogradec, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Për garancitë e të cilat janë brenda afatit ligjorë, në momentin e përfundimit të afatit t’i kërkohet subjekteve zbatuese paraqitja e dokumentacionit ligjorë dhe pas verifikimit të punimeve të behet likuidimi i garancive.

24.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të hartojë rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

26.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Komisioni i blerjeve të vogla, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

26.2. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor për 10 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga komisioni i blerjeve të vogla të përlllogariten penalitetet përkatëse dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

Në vijimësi

27.1. Rekomandimi: DPKZHT dhe Bashkia Pogradec të marrë masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon.

Të kërkohej të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.

28.1. Rekomandimi: DPZHTS Pogradec të marrë masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Gjithashtu, DPZHTS Pogradec, të shqyrtojë me përparësi të gjitha kërkesat e parashtruara nga këto autoritete dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi deri në plotësimin e kërkesave.

29.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Pogradec të marrë masat për:

- Të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. DPKZHT dhe Bashkia Pogradec të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, brenda afateve të përcaktuara në ligj.

- Shqyrtimin e vetëm atij dokumentacioni që kalon përmes sistemit elektronik të lejeve, të kërkojnë nëpërmjet këtij sistemi plotësimin e dokumentacionit, në të kundërt të refuzojnë kërkesat për pajisje me leje, duke respektuar afatet dhe dispozitat ligjore.

- Të marrë në konsideratë vetëm ato dokumente të projektit ndërtimor, të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve të cilat janë të nënshkruar elektronikisht nga hartuesit e tyre ose aplikanti.

- Të kontrolluar nëse dokumentet e pronësisë për parcelat në zhvillim, konkretisht kartelat e pasurive të paluajtshme, janë të rifreskuara sipas afateve të përcaktuara në ligj, në të kundërt, të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi që nuk i respekton këto përcaktime.

30.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, IMTV dhe DPKZHT të marrin masa dhe të përdorin të gjithë instrumentet për të kryer kontrollet e nevojshme deri në marrjen e sigurisë së plotë se objektet për të cilat aplikohet për leje zhvillimi/ndërtimi nuk kanë filluar ndërtimin pa marrë miratimet e nevojshme sipas ligjit. Këto struktura duhet të rrisin bashkëpunimin midis tyre me qëllim krijimin e kushteve për një zhvillim të kontrolluar të territorit. Gjithashtu, përpara miratimit të lejeve të përdorimit, DPKZHT dhe IMTV duhet të bashkëpunojnë duke ushtruar aktivitetin e vet inspektues mbi dokumentacionin e dorëzuar në sistemin elektronik të lejeve, si dhe duke inspektuar në terren, për të marrë siguri të lartë mbi zbatimin e objekteve sipas projekteve të miratuara.

30.2. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, DPKZHT dhe IMTV të marrin masa për të mos lejuar vendosjen në përdorim të objekteve të cilat nuk janë pajisur me leje përdorimi. Për çdo rast të

konstatuar, këto autoritete duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre duke marrë masat e parashikuara në ligj përkundrejt këtyre subjekteve.

31.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor me arsim të lartë, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim rritjen e efektivitetit të punës inspektuese të kësaj strukture.

32.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec, të marrë masat që për çdo rast të konstatuar në shkelje të lejes së ndërtimit ose në mungesë të saj, të ndërmarrin të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e kundërvajtësit, si dhe kthimin në gjendjen fillestare të objektit të kundërligjshëm kur parashikohet në ligj, nxjerrjen e vendimit për pezullimin e punimeve për ato raste kur kundërvajtësi ka nevojë për kohë sipas përcaktimeve për plotësimin e dokumentacionit ligjor, vendosjen e masave administrative ndëshkim me gjobë në raport të drejtë me shkeljen e konstatuar, nxjerrjen e vendimit të prishjes, ndërmarrjen e hapave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësin dhe për heqjen e licensave profesionale për profesionistët përgjegjës, si dhe të kërkojë pranë gjykatës administrative nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për ato raste kur gjobat nuk paguhen brenda afateve, të gjitha këto në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda afateve të parashikuara.

32.2. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planeve të punës në mënyrë periodike, çdo muaj, sipas zonave të kontrollit, me qëllimin rritjen e efektivitetit të punës inspektuese dhe garantimin e zhvillimit të kontrolluar të territorit.

32.3. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec, të marrë masa për rritjen e bashkëpunimit me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe hartimin e raportimeve çdo tre muaj mbi aktivitetin e IMTV, me qëllimi rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional, marrjen e asistencës për të gjitha rastet kur është nxjerrë vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nga ana e IMTV, si dhe vendosjen në dijeni të IKMT për të gjithë veprimtarinë e saj.

32.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec të merren masa për të bërë të mundur përlllogaritjen, kontabilizimin dhe aplikimin e kamat-vonesave, për të gjithë kundërvajtësit që nuk i paguajnë gjobat brenda afateve të parashikuara, me qëllim ndëshkimin në raport të drejtë të kundërvajtësve, si dhe aplikimin e masave shtrënguese.

33.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

MASA ORGANIZATIVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

14.1. Rekomandimi: Të merren masa të menjëhershme për rishikimin e projekt-preventivit nga palët: Sipërmarrësi i punimeve “R.” SH.P.K. & “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1779/12 prot., datë 17.09.2020, të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit të “Rruga e Mokrës” nga Mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Bashkia Pogradec në cilësinë e AK, për zërat e punimeve: “Shtresë stabilizanti t=5cm”, “FV tub p.v.c shkarkim Ø 80 mm”, “FV tub p.v.c shkarkim Ø110 mm” dhe “FV tub fleksibël Ø 40;60 mm me tel bari në të” si zë i përsëritur në preventivin e projektit. Gjithashtu, mbikëqyrësi i punimeve t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve plotësimin e dosjes teknike me dokumentet: (Plan-organizimin e punimeve të ndërtimit; Ndryshimet në projekt- preventiv dhe miratimin e tyre nga AK; Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve; Librezën e masave; Situacionet mujore pjesore dhe progresive; Proces verbalet e miratimit të materialeve; Ditarin e objektit; Pasqyrën e realizimit të punimeve;

Procesverbalet e punimeve të maskuara; Provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, si: hekur, beton, etj; Dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse; Çertifikat e cilësisë së materialeve).

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **490,380** lekë pa TVSH nga Kontraktori “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot., datë 20.07.2018, me objekt “Sistemim rrugësh blloku Goricë”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **69,600** lekë pa TVSH nga Kontraktori “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot., datë 20.07.2018, me objekt për një shtesë fondi në kontratë “Sistemim rrugësh blloku Goricë”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **652,543** lekë pa TVSH nga Kontraktori “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1757/15 prot., datë 14.09.2020, të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit “Rruga e Kabashit”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

5.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera.

Dalja e përgjegjësi, mbi kryerjen e zërave të punimeve “Punime për ndarje e prurjes B-2 (D1)”, “Punime për pusët ajrimit” e “Punime për Pusetat e Shkarkimit” “Gërmim dheu me krahë bankinë kanali” sipas PZ dhe ST në shumën **4,369,124 lekë**, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec, sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve si dhe kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë. Në rast të kundërt, diferenca në sasi dhe në vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Bashkia Pogradec, të marrin masa që:

- Në periudhat në vijim në lidhje me procedurat e prokurimit, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

- Për të gjithë procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera nuk duhet të hidhen në prokurim pa marrë më parë miratimin nga Instituti i Ndërtimit për oponencën teknike të investimit.

- Të bëhet inventarizimi dhe arkivimi i të gjitha dosjeve të mbyllura dhe arkivuara sipas të dhënave të sistemit të SPE.

- Të bëhen pjesë e dosjes së procedurës, DST, procesverballi i hapjes së procedurës, raporti përmbledhës dhe vendimi i titullarit të AK për shpalljen fitues.

Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Pogradec dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për një përdorim me efektiv të fondeve në vlerën **2,264,536 mijë lekë pa TVSH**.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A- MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik;
 - Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi;
 - Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut;
 - Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
 - Nuk janë përgatitur planet e veprimit për minimizimin e risqeve me nivel të lartë;
 - Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit;
 - Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
 - Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit,
- Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 10 pika 2, nenin 11, nenin 12, nenin 21 pika 5, nenin 23 shkronja “c” pika 1, nenin 26, dhe nenin 27 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 11 faqe 17 të Raportit të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Menaxhimi i Lartë i Bashkisë Pogradec, të marrë masat të ngrejë një sistem efektiv të mjedisit të kontrollit, të hartojë strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, si dhe të hartojë procedura dhe rregulla të shkruara në lidhje me dokumentimin dhe frekuencën e raportimit për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2025 e vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Kryetari i Bashkisë Pogradec, nuk ka marrë masat për ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brëndshëm si organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm në lidhje me planin strategjik dhe vjetor, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 12 germa “b” të ligjit nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 11 faqe 17 të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec të marrë masat për ngritjen e Komitetit të Auditit të Brëndshëm, në mbështetje të njësisë auditimit të brendshëm dhe monitorimin e zbatimit e rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit të brendshëm dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Brenda vitit 2025

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Bashkisë Pogradec rezulton se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe buxhetit të shtetit, për vitin 2023 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2023 planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 1,510,537 mijë lekë, ndërsa realizimi 1,178,118 mijë lekë, ose në masën 78%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 511,150 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 476,093 mijë lekë, ose në masën 93%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 94%. Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 575,760 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 395,027 mijë lekë, ose në masën 69%. Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 241,803 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 144,483 mijë lekë, ose në masën 60 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Pogradec në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2023 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2023. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 18 faqe 25 të Raportit të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë/sectorët e tjerë të bashkisë Pogradec, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të theksuara në realizimin të buxhetit dhe krijimin e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Bashkia Pogradec nuk ka shlyer detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve sipas detyrimeve kontraktuale, nuk ka planifikuar grafik për shlyerjen e tyre gjatë vitit 2023 si dhe ka planifikuar investime pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të reja prapambetura, më konkretisht:

- Detyrime të prapambetura në datën 01.01.2023 janë në vlerën 347,178,628 lekë;
- Në planin buxhetor të vitit 2023 nuk ka planifikuar grafik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, por është likuiduar vlera prej 146,099,377 lekë ose në masën prej 42% ndaj totalit;
- Gjithashtu bashkia ka planifikuar investime pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të reja prapambetura gjë e cila është në kundërshtim me:
 - a. kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve;
 - b. nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - c. UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2023.*(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 18 faqe 25 të Raportit të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrin masa për hartimin e grafikut të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në vite duke pasur prioritet datat e krijimit të tyre dhe afateve të përcaktuar në kontratë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023 është në vlerën 616,306 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 391,334 mijë lekë ose në masën 63% me një diferencë në vlerën 199,873 mijë lekë. Nga analiza e zërave konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, germa “c”; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, germa “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 25 faqe 36 të Raportit të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për kryerjen e analizave të detajuara në hartimin e planit të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, në përputhje me realizimin e vitit të mëparshëm, arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe objektivave të saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se Bashkia Pogradec për vitin 2023 nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë, për t’i dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare për tre njësitë e vartëse respektivisht 1.Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekracionit; 2. Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike dhe 3. Qendra Arsimore. Veprimet dhe mos veprimet janë në kundërshtim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”; neni 9,pika 4, germa “d”, neni 12 pika 2. germa “b”. UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar kapitulli II, pikat 98; 99; 100; 101, germa “b”, pika 118. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 36 faqe 49 të Raportit të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrin masa për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 168,828,141 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 148,802,909 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 20,025,232 lekë e cila vjen si rezultat i rritjes së debitorëve të qirave etj. Nga analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në vlerën 143,834,560 lekë, si dhe debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën

40,440,441 lekë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 36 faqe 49 të Raportit të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme për analizimin, rakordimin dhe saktësimin e vlerës së detyrimeve të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” (debitorë) më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 36,210,338 lekë (Formati nr.1). Kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2023 të cilat trashëgohen në vitin 2024, e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financimi i pritshëm nga buxheti” e cila paraqitet në vlerën 36,210,338 lekë, por nuk rakordon me klasën katër në pasiv të bilancit respektivisht: - llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 147,725,695 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 15,027,116 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 2,088,586 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 22,902,333 lekë, llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 3,166,177 lekë dhe llogaria 467 “Kreditor të ndryshëm” në vlerën 46,383,532 lekë çka ka sjell një nënvlerësim të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” në vlerë 201,083,101 lekë që i përket vlerës së detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE me shkresën nr. 826/5 prot., datë 28.02.2024 dhe regjistruar në llogarinë 12 “Rezultatet e mbartura” me vlerë 201,083,101 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 36 faqe 49 të Raportit të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për analizimin dhe pasqyrimin e saktë të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” si dhe llogarisë 467 “Kreditor të ndryshëm” e gjendjes së saj.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën neto 36,506,228 lekë në mbyllje të vitit ushtrimor 2023. Nga analiza e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” konstatohet se janë kontabilizuar 41 projekte për të cilat drejtoria e financës nuk ka bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2. klasa 2, “Aktivet afatgjata”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 36 faqe 49 të Raportit të Auditimit)*

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Pogradec të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet të llog. 202 “Studime dhe Kërkime” sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke debituar llogarinë përkatëse 212 “Ndërtesa e

konstruksione” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” sipas zërave për të cilën janë realizuar, për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

10. Gjetje nga auditimi. Nga analiza e llogarive të Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, rezulton se Bashkia ka kryer procesin e inventarizimit të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 3,874,074 lekë; llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 698,494,722 lekë; llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 115,508,891 lekë; llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,077,389,480 lekë; llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 11,985,774 leke dhe llogarisë 215 “Mjete transporti” në vlerën 9,276,022 lekë. Vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozicionit financiar 2023, është marrë bruto nga pasqyrat financiare pasi nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.

Drejtoria e financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2023, Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, “Aktive afatgjata materiale” dhe pika 33. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 36 faqe 49 të Raportit të Auditimit)*

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të ngrejë një grup pune për zbatimin dhe analizimin e llogarive të Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale” për të dhënë informacion kontabël të saktë, të besueshëm dhe të dokumentuar në regjistrat përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 603,083,834 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,630,749,036 lekë. Shtesat për vitin 2023 janë në vlerën 1,256,936,583 lekë dhe pakësimet në vlerën 229,271,380 lekë. Referuar analizës së llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” konstatohet se Drejtoria e Financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2023, në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1 pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, “Aktive afatgjata materiale” dhe pika 33. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 36 faqe 49 të Raportit të Auditimit)*.

11.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, të pasqyroj vetëm ato investime të cilat janë në proces zbatimi në fazë terreni të cilat nuk janë pajisur me akt kolaudimi.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

12.Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Pogradec më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 78,696,639 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 138,122,996 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, por mungojnë të dhënat esenciale si data e hyrjes, data e përfundimit të afatit të garancisë. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 36 faqe 49 të Raportit të Auditimit)*

12.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanistikës të evidentojë subjektet të cilat kanë shlyer detyrimin për të cilin ju është ngurtësuar vlere 5% e garancisë së punimeve dhe të bëjë likuidimin e kësaj vlere për subjektet.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 300,000 lekë dhe më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 300,000 lekë. Kjo vlerë është e mbartur ndër vite e pa analizuar dhe ndikon në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të aktiveve afatgjata financiare. Referuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, Bashkia Pogradec është aksionare me 36.10% tek Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA kapital në vlerë monetare prej 36,100 mijë lekë e cila nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2023, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 36 faqe 49 të Raportit të Auditimit)*

13.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024, të marrë masa për regjistrimin e vlerës 36,100 mijë lekë në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” të aksioneve të “Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA, me qëllim paraqitjen e saktë të vlerave kontabël në pasqyrat financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

14. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” (Aparati i Bashkisë) më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 4,631,125 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,631,125 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlerën 4,631,125 lekë është e mbartur nga vitet e mëparshme për të cilat kontabilizimi është kryer pa dokumentacion mbështetës si procesverbal mbi vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit apo vendimmarrje nga Këshilli Bashkiak për nxjerrje të aktiveve jashtë përdorimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimi e MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe

trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 36 faqe 49 të Raportit të Auditimit)

14.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e kontabilizuar si të dëmtuara në llogarinë 24 “Aktive të dëmtuara” në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Bashkia Pogradec administron në total 3,775 pasuri sipas VKM-ve përkatëse për të cilat nuk është bërë pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet si dhe nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ASHK Pogradec. Gjithashtu nuk ka rakordim me ASHK, për asetet pronë e Komunave, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve, nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje, nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve si dhe nuk është aplikuar në ASHK për regjistrimin e tyre si dhe nuk ka krijuar komisionit e përbashkët në zbatim të VKM së nr.28 datë, 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve – ASHK ku kërkohet një person nga ASHK-ja në krijimin e komisionit me qëllim inventarizimin dhe regjistrimin dhe përditësimin e inventarëve. Mosveprimet e mësipërme janë në shkëlqje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30, pika 35/a si dhe neni 37 i ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV. VKM së nr.28 datë, 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve – ASHK. ”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 49 faqe 53 të Raportit të Auditimit)

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec të marrë të gjitha masat për ngritjen e një grupi pune me qëllim verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka Bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre me VKM me qëllim regjistrimin në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm dërguara nga KLSH me shkresën nr. 522/13 prot., datë 29.12.2023 në Bashkinë Pogradec, konstatohet se nga kryetari i bashkisë nuk janë ndërmarr të gjitha procedurat për zbatimin e rekomandimeve si vijon:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 49 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 11 janë zbatuar, 2 zbatuar pjesërisht, 5 janë në proces zbatimi dhe 31 nuk janë zbatuar. Janë zbatuar 22 % e masave organizative dhe 63 % nuk janë zbatuar. Nga masat e zbatuara pjesërisht ose të pa zbatuara nuk rikërkohen 13 masa organizative pasi statusi i tyre është reflektuar në auditimin aktual.

- Nga 5 masa shpërbllim dëmi të rekomanduara në vlerën 7,027,330 lekë, 4 rekomandime në vlerën 2,658,166 janë konsideruar të zbatuar nga të cilat, (për 3 masa është arkëtuar vlera 753,788 lekë

për 1 masë është në proces gjyqësor në vlerën 1,904,378 lekë) si dhe 1 masë është në zbatuar pjesërisht në vlerën 4,369,124 lekë.

- Për uljen e borxhit janë lënë 6 rekomandime në vlerën 275,701,347 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, 1 rekomandime në proces zbatimi dhe 5 rekomandime janë të pa zbatuara.

- Janë lënë 16 masa disiplinore dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 15 janë zbatuar plotësisht dhe 1 nuk është zbatuar. Sa më sipër rezulton se Bashkia Pogradec nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të përcjell me shkresën 522/13 datë 29.12.2023. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH-së”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 53 faqe 104 të Raportit të Auditimit)*

16.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

Për 20 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

10.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Pogradec të merren masa për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave të qirasë.

11.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të merren masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimit të tyre.

12.2. Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e komisionit të inventarizimit me qëllim realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

14.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Pogradec të merren masa të menjëhershme për ngritjen një grupi pune i cili të kryejë verifikimet dhe rakordimet ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare për vlerën totale **5,424,007 lekë** për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 2,904,812 lekë, llogarinë 215 “Mjete transporti” në vlerën 1,729,695 lekë dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 789,500 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit pa dokumentacion justifikues nga NMIPP Pogradec. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca ndërmjet gjendjes faktike dhe atë të kontabilizuar në pasqyrat financiare të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të diferencave në inventar nga personat përgjegjës.

24.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të hartojë rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e

procesit të rekrutimeve të reja, si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

26.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe Komisioni i blerjeve të vogla, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

26.2. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor për 10 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga komisioni i blerjeve të vogla të përlogariten penaltitetet përkatëse dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

27.1. Rekomandimi: DPKZHT dhe Bashkia Pogradec të marrë masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon.

Të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.

28.1. Rekomandimi: DPZHTS Pogradec të marrë masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Gjithashtu, DPZHTS Pogradec, të shqyrtojë me përparësi të gjitha kërkesat e parashtruara nga këto autoritete dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi deri në plotësimin e kërkesave.

29.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Pogradec të marrë masat për:

- Të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. DPKZHT dhe Bashkia Pogradec të marri masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, brenda afateve të përcaktuara në ligj.

- Shqyrtimin vetëm të dokumentacionit që kalon përmes sistemit elektronik të lejeve, të kërkojnë nëpërmjet këtij sistemi plotësimin e dokumentacionit, në të kundërt të refuzojnë kërkesat për pajisje me leje, duke respektuar afatet dhe dispozitat ligjore.

- Të marrë në konsideratë vetëm ato dokumente të projektit ndërtimor, të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve të cilat janë të nënshkruar elektronikisht nga hartuesit e tyre ose aplikanti.

- Të kontrolluar nëse dokumentet e pronësisë për parcelat në zhvillim, konkretisht kartelat e pasurive të paluajtshme, janë të rifreskuara sipas afateve të përcaktuara në ligj, në të kundërt, të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi që nuk i respekton këto përcaktime.

30.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, IMTV dhe DPKZHT të marrin masa dhe të përdorin të gjithë instrumentet për të kryer kontrollet e nevojshme deri në marrjen e sigurisë së plotë se objektet për të cilat aplikohet për leje zhvillimi/ndërtimi nuk kanë filluar ndërtimin pa marrë miratimet e nevojshme sipas ligjit. Këto struktura duhet të rrisin bashkëpunimin midis tyre me qëllim krijimin e kushteve për një zhvillim të kontrolluar të territorit. Gjithashtu, përpara miratimit të lejeve të përdorimit, DPKZHT dhe IMTV duhet të bashkëpunojnë duke ushtruar aktivitetin e vet inspektues mbi dokumentacionin e dorëzuar në sistemin elektronik të lejeve, si dhe duke inspektuar në terren, për të marrë siguri të lartë mbi zbatimin e objekteve sipas projekteve të miratuara.

30.2. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, DPKZHT dhe IMTV të marrin masa për të mos lejuar vendosjen në përdorim të objekteve të cilat nuk janë pajisur me leje përdorimi. Për çdo rast të

konstatuar, këto autoritete duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre duke marrë masat e parashikuara në ligj përkundrejt këtyre subjekteve.

31.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë të gjitha masat për plotësimin e strukturës me inspektor me arsim të lartë, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim rritjen e efektivitetit të punës inspektuese të kësaj strukture.

32.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec, të marrë masat që për çdo rast të konstatuar në shkelje të lejes së ndërtimit ose në mungesë të saj, të ndërmarrin të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e kundërvajtësit, si dhe kthimin në gjendjen fillestare të objektit të kundërligjshëm kur parashikohet në ligj, nxjerrjen e vendimit për pezullimin e punimeve për ato raste kur kundërvajtësi ka nevojë për kohë sipas përcaktimeve për plotësimin e dokumentacionit ligjor, vendosjen e masave administrative ndëshkim me gjobë në raport të drejtë me shkeljen e konstatuar, nxjerrjen e vendimit të prishjes, ndërmarrjen e hapave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësin dhe për heqjen e licensave profesionale për profesionistët përgjegjës, si dhe të kërkojë pranë gjykatës administrative nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për ato raste kur gjobat nuk paguhen brenda afateve, të gjitha këto në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda afateve të parashikuara.

32.2. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planeve të punës në mënyrë periodike, çdo muaj, sipas zonave të kontrollit, me qëllimin rritjen e efektivitetit të punës inspektuese dhe garantimin e zhvillimit të kontrolluar të territorit.

32.3. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec, të marrë masa për rritjen e bashkëpunimit me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe hartimin e raportimeve çdo tre muaj mbi aktivitetin e IMTV, me qëllimi rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional, marrjen e asistencës për të gjitha rastet kur është nxjerrë vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nga ana e IMTV, si dhe vendosjen në dijeni të IKMT për të gjithë veprimtarinë e saj.

32.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec të merren masa për të bërë të mundur përlllogaritjen, kontabilizimin dhe aplikimin e kamat-vonesave, për të gjithë kundërvajtësit që nuk i paguajnë gjobat brenda afateve të parashikuara, me qëllim ndëshkimin në raport të drejtë të kundërvajtësve, si dhe aplikimin e masave shtrënguese.

33.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

Për 1 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara;

14.1. Rekomandimi: Të merren masa të menjëhershme për rishikimin e projekt-preventivit nga palët: Sipërmarrësi i punimeve “R.” SH.P.K. & “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1779/12 prot., datë 17.09.2020, të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit të “Rruga e Mokrës” nga Mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Bashkia Pogradec në cilësinë e AK, për zërat e punimeve: “Shtresë stabilizanti t=5cm”, “FV tub p.v.c shkarkim Ø 80 mm”, “FV tub p.v.c shkarkim Ø110 mm” dhe “FV tub fleksibël Ø 40;60 mm me tel bari në të” si zë i përsëritur në preventivin e projektit. Gjithashtu, mbikëqyrësi i punimeve t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve plotësimin e dosjes teknike me dokumentet: (Plan-organizimin e punimeve të ndërtimit; Ndryshimet në projekt- preventiv dhe miratimin e tyre nga AK; Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve; Librezën e masave; Situacionet mujore pjesore dhe progresive; Proces verbalet e miratimit të materialeve; Ditarin e objektit; Pasqyrën e realizimit të punimeve;

Procesverbalet e punimeve të maskuara; Provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura, si: hekur, beton, etj; Dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse; Çertifikat e cilësisë së materialeve).

Për 3 masa shpërblim dëmi të cilat janë konsideruar të pa zbatuara;

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **490,380** lekë pa TVSH nga Kontraktori “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot., datë 20.07.2018, me objekt “Sistemim rrugësh blloku Goricë”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **69,600** lekë pa TVSH nga Kontraktori “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5532/1 prot., datë 20.07.2018, me objekt për një shtesë fondi në kontratë “Sistemim rrugësh blloku Goricë”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pogradec, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **652,543** lekë pa TVSH nga Kontraktori “R.” SH.P.K., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1757/15 prot., datë 14.09.2020, të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit “Rruga e Kabashit”, Bashkia Pogradec, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Për 1 masa shpërblim dëmi e konsideruar zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

5.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera.

Dalja e përgjegjësisë, mbi kryerjen e zërave të punimeve “Punime për ndarje e prurjes B-2 (D1)”, “Punime për pusët ajrimit” e “Punime për Pusetat e Shkarkimit” “Gërmim dheu me krahë bankinë kanali” sipas PZ dhe ST në shumën **4,369,124 lekë**, të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec, sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve si dhe kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë. Në rast të kundërt, diferenca në sasi dhe në vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Për 1 eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike e konsideruar e pa zbatuat, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Bashkia Pogradec, të marrin masa që:

- Në periudhat në vijim në lidhje me procedurat e prokurimit, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

- Për të gjithë procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera nuk duhet të hidhen në prokurim pa marrë më parë miratimin nga Instituti i Ndërtimit për oponencën teknike të investimit.

- Të bëhet inventarizimi dhe arkivimi i të gjitha dosjeve të mbyllura dhe arkivuara sipas të dhënave të sistemit të SPE.

- Të bëhen pjesë e dosjes së procedurës, DST, procesverbali i hapjes së procedurës, raporti përmbledhës dhe vendimi i titullarit të AK për shpalljen fitues.

Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Pogradec dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për një përdorim me efektiv të fondeve në vlerën **2,264,536 mijë lekë pa TVSH**.

16.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Pogradec për periudhën e veprimtarisë ekonomike, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH-ja për nxjerrjen e përgjegjësi të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë në vlerën 115,508,846 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë krijuar debitorë në vlerën 28,325,714 lekë. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, për abonentët familjarë janë në vlerën 143,834,560 lekë vlerë e cila nuk është kontabilizuar dhe përbën të ardhura të munguar për buxhetin e Bashkisë Pogradec si më poshtë:

- Vlera 2,812,396 lekë për 7,669 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore;
- Vlera 26,975,322lekë për 6,782 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës;
- Vlera 6,421,216 lekë për 6,782 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i taksës së truallit;
- Vlera 58,302,458 lekë për 6,782 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit;
- Vlera 21,769,834 lekë për 6,782 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i tarifës së gjelbërimit;
- Vlera 7,647,182 lekë për 6,782 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec nga mos arkëtimi i tarifës së mirëmbajtjes së varreze.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 25 faqe 36 të Raportit të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për

arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2023, në vlerën totale 143,834,560 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kaluar është konstatuar se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore në vlerën 57,139,720 lekë. Gjatë vitit 2023 janë likuiduar në total 14,309,074 lekë duke ngelur debitor në vlerën 42,830,646 lekë që i përket periudhës 2011-2022 si dhe janë krijuar debitorë të rinj në totali në vlerën 27,277,277 lekë të ndara në subjekte biznes i vogël në vlerën 7,677,327 lekë dhe biznes i madh në vlerën 19,599,950 lekë. Në total detyrimet tatimore progresive më datë 31.12.2023, për subjektet biznes i vogël dhe i madh janë në vlerën 70,107,923 lekë, vlerë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Pogradec, në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, ku përcaktohet që: “Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit”, Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore” si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 3, pikat 9-10. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 25 faqe 36 të Raportit të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2023, në vlerën totale 70,107,923 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Pogradec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave emërore për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e Aluizinit Pogradec janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe të destinuara për regjistrim në ZVRPP (sot ASHK Pogradec). Nga ku rezulton se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë detyrimi për këtë taksë është në vlerën 22,207,998 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, vlera e detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 18,232,443 lekë. Në total detyrimi për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë më datë 31.12.2023, është në vlerën 40,440,441 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 25 faqe 36 të Raportit të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 40,440,441 lekë ndaj 1,913 personave.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se në territorin e Bashkisë së Pogradecit dhe në Njësitë Administrative Buçimas dhe Çerravë figurojnë 14 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 14 subjekte janë pajisur me autorizim 14 subjekte, nga të cilët 11 subjekte kanë paguar vlerën e plotë të licencës dhe për këto subjekte është lëshuar licencë më afat 5 vjeçar në vlerën 11,000,000 lekë, një subjekte është pajisur me autorizim 1 vjeçar nga bashkia Pogradec në vlerën 200,000 lekë si dhe ka mbetur pa u likuiduar vlera prej 1,300,000 lekë nga subjektet "H." SH.P.K. dhe "E." SH.P.K. vlerë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Pogradec, në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, Ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, nenet 4,15 dhe 20/2" dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3, pika 15.1. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 25 faqe 36 të Raportit të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Bashkia Pogradec, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën në ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, të papaguara nga 2 subjektet në vlerën 1,300,000 lekë konkretisht subjekti "H." SH.P.K. në vlerën 300,000 lekë dhe subjekti "E." SH.P.K. në vlerën 1,000,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në Bashkinë Pogradec ushtrojnë aktivitet 30 subjektet të pajisura me kontrata koncesionare për shfrytëzimin dhe ndërtimin e hidrocentraleve me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, nga të cilat 22 subjekte ushtrojnë aktivitet minerar në zonat e mbrojtura dhe 8 subjekte jashtë zonës së mbrojtur. Bashkisë Pogradec për 8 subjekte private për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri gëlqeror, hekur nikel, krom dhe rërë kuarc referuar lejeve minerare të miratuara nga MEI, për të cilat nuk ka vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private për sipërfaqen totale prej 293.1. Detyrimi dysHEME/minimal është përlogaritur përafërsisht **18,172,200 për vitin 2023**, për 8 subjekte **vlerë e cila përbën të ardhura të të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 391, datë 21.06.2006, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar me VKM nr. 559, datë 29.7.2022 "Për caktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe prodhim i lëndës drusore dhe jodrusore pyjore" në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 391, datë 21.06.2006, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" i ndryshuar". *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 25 faqe 36 të Raportit të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec të marrë të gjitha masat e menjëhershme për ngritjen e një grupi pune me qëllim verifikimin e sipërfaqeve që ato shfrytëzojnë, përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqeveve totale prej 293.1 duke aplikuar tarifat dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit **18,172,200 lekë** për 8 subjekte.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) të nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996, “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, nenit 12 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pogradec** të vlerësojë shkeljet të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, **“Vërejtje” për 2 (dy) punonjësit**, si më poshtë:

1. znj. I. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës.

2. znj. A. S. me detyrë përgjegjëse në Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimin Financiar.

Për problematikat e konstatuara në lidhje me Pasqyrat financiare, si më poshtë vijon:

- Nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë, për ti dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare për tre njësitë e vartëse.

-Nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikisht këto zëra, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

- Në llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në vlerën 143,834,560 lekë, si dhe debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 40,440,441 lekë.

- Në planin e buxhetit vjetor 2023 nuk ka planifikuar një grafik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura progresive vlerën 347,178,628 mijë lekë e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT